

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXIII i botimit, nr. 262, Gusht 2025

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Viti 2025, 100-vjetorit të lindjes së Albanologut Martin Camaj "Nderi i Kombit" dhe "Qytetar Nderi" i qytetit të Shkodrës



KORRIKU I VITIT 1915 I HARRUEM I DUKAGJINIT

2

- KUSH E VRAU KUJTESËN KOMBËTARE? -

Historia asht mësuesja ma e mirë e popujve. Ajo asht si një nanë e urtë që t'a jep të vërtetën pa zbulurime, por veç kur nuk ia vërvitin gjuhën manipulimit, siç ka ndodhë shpesh ndër trojet tona. Se kur historia përdhuhet prej politikave të rrumpakes, kur gjaku i të ramëve për liri nuk përmendet, por shpërfillet e përbuzet, atëherë nuk kena ma histori – kena turp. Korriku i vjetit 1915 për Dukagjinin e Shkodrën që e administronte, nuk ishte as verë, as pushime, as zhurmë feste. Ishte një korrik gjaku, flake, tymi, epepeje dhe dhimbje. Ishte përballja burrnore e malsorëve me forcat pushtuese serbo-malazeze, që kishin vu në shënjestër çdo maje, çdo kullë, çdo vend ku fryma shqiptare s'i kishte ulë brekët as turkut, as sllavit, as kujtdo që vinte me pranga n' dorë.

PORTRETI I PRINCIT LEKË DUKAGJINIT NË FOTOGRAFITË E MARUBIT: REALITET APO KONSTRUKSION ARTISTIK?

Ky punim synon të analizojë origjinën dhe natyrën e një fotografie të famshme që paraqitet si portreti i Princit Lekë Dukagjinit - një imazh që është bërë ikonë në ndërgjegjen kombëtare shqiptare. Duke shqyrtuar dëshmitë e paraqitura nga studiuesi Mark Gjon Pali, argumentohet se ky portret nuk është një dëshmi historike autentike, por një konstrukt artistik i krijuar nga Kel Marubi në fillim të shekullin XX.

Përmes këtij rasti, trajton edhe mënyrën se si arti vizual është përdorur për të mitizuar figura historike, sidomos në mungesë të të dhënave burimore. Krahas kësaj, trajtohet përmasimi real historik dhe juridik i Princit Lekë Dukagjinit përmes Kanunave të një ndër veprat më të rëndësishme të të drejtës tradicionale Shqiptare.

5

Humanisti i shquar shqiptar dhe bashkëpunëtor i afërt i Gjergj Kastriotit

ARQIPESHKVI PAL ENGJËLLI (1417 - 1470)

Në plejadën e humanistëve të shquar shqiptarë të shekujve XV, XVI, një vend të merituar ka Imzot PAL ANDREA ENGJËLLI nga familja e njohur e Engjëllorëve, dukë të Drishtit, familje e njohur patriote që luajti një rol me rëndësi në mesjetën shqiptare e sidomos në periudhën e Gjergj Kastrioti. Kjo familje me titull fisnikërie kishte lidhje të ngushta me familjet kryesore princërore shqiptare të kohës. Pal Engjëlli jetoi e veproi në epokën e Gjergj Kastriotit si prelat fetar e si humanist i përmendur dhe diplomat i shtetit të përqendruar arbëresh të kësaj kohe. Pothuajse bashkëmohatar me Heroin Kombëtar, ai qe njëheri edhe mik i tij, (ata te dy ishin djem te zesh – nenat motra, shënim i Dr. Mark Palnikaj)⁶, siç pohon disa herë Marin Barleti në veprën e njohur "De vita et Gestis Scanderbeghi, Epirotarum Principis" Roma 1488 - 1510, qe këshilltar dhe diplomat i tij.

6

PAKETA E MALEVE, NDËRHYRJE SOCIALE DHE EKONOMIKE QË SYNON ZHVILLIMIN E ZONAVE MALORE

Dikur thuhej "T'u qepemi kodrave dhe maleve, t'i bëjmë ato pjellore si dhe fushat". Sot janë braktisur fushat, toka nuk punohet, jane shkrirë ish- NB-të, por në skenë na ka dalë "Paketa e Maleve". Sipas burimeve të Telegraf.al në "Paketën e Maleve" janë piketuar për t'u përvetësuar zonat më të mira turistike nga oligarkia e lidhur dhe ortakët e zyrtarëve.

Paketa e Maleve është një paketë masash dhe ndërhyrjesh politike, sociale dhe ekonomike që synon zhvillimin e zonave malore, rritjen e cilësisë së jetës së banorëve të tyre dhe frenimin e braktisjes së territoreve. Kjo iniciativë përfshin një sërë politesh publike për të përmirësuar jetesën, aksesin në shërbime ...

4

KORRIKU I VITIT 1915 I HARRUEM I DUKAGJINIT

- KUSH E VRAU KUJTESËN KOMBËTARE? -

Historia asht mësuesja ma e mirë e popujve. Ajo asht si një nanë e urtë që t'a jep të vërtetën pa zbulurime, por veç kur nuk ia vërvitin gjuhën manipulimit, siç ka ndodhë shpesh ndër trojet tona. Se kur historia përdhuhet prej politikave të rrumpakes, kur gjaku i të ramëve për liri nuk përmendet, por shpërfillet e përbuzet, atëherë nuk kena ma histori – kena turp.

Korriku i vjetit 1915 për Dukagjinin e Shkodrën që e administronte, nuk ishte as verë, as pushime, as zhurmë feste. Ishte një korrik gjaku, flake, tymi, epopeje dhe dhimbje. Ishte përballja burrnore e malsorëve me forcat pushtuese serbo-malazeze, që kishin vu në shënjestër çdo maje, çdo kullë, çdo vend ku fryma shqiptare s'i kishte ulë brekët as turkut, as sllavit, as kujtdo që vinte me pranga n' dorë.

Dukagjini nuk e njohu kurrë zgjedhën osmane – as nuk e pranoi, as nuk e deshti. I qëndroi besës e flamurit në çdo kthesë të historisë. Nuk asht rastësi që Dukagjini luftoi për ruajtjen e gjymtyrëve kombëtare Plavë, Guci Hot e Grude, qe flakë e kryengritjeve të 1910, 1911, 1912, e në mbrojtjen e Shqipnisë fëmijë, kur Evropa na la jetimë.

Në qershor e korrik të 1915-ës, malsorët e Nikaj-Merturit, Shalës, Shoshit e Pultit, i dhanë një mësim nderi malazezëve. Qafa e Kolshit, Currajt Epermë dhe gjithë pellgun i Nikaj Merturit shkruan një histori gjykuar drede dhe heroizmi popullor qe nen ndere historike. Në Gimaj e Dakaj të Shalës, me 4 e 5 korrik, ranë në dorë 1500 rob malazez, të cilët u kaluen ndër gryka



pushkësh me kryet ulun e nderin e hupun.

Por pushtuesi, si gjithmonë, nuk u ndal. Me dredhi e pabesi, iu përvesh Pultit. Mesi i korrikut u kthye në tragedi. Vetëm në Plan u vranë 79 vetë, përfshi trimat e djelmisë: Mehmet Shpendin, Çun Nikën e Marash Delinë. E s'pati kush i qau, se shtet s'kishim – e as dhimbje zyrtare s'ka pasë kurrë për ta.

Mbasandej, me përforcime të reja, malazezët i vun flakën, Pultit Shoshit e Shalës. Kullat u dogjën, arat u shkatrruen, gjaja e gjallë u grabit. Në tanë atë zjarr e rrëmujë, ne mbarë ato male u flijuan mbi

120 burra që dhanë jetën për këtë tokë – e sot nuk kanë as një pllakë, as një titull, as një përrulje zyrtare.

Molla e Shoshit, fshat i vogël, por me zemër të madhe, në dhjetor 1916 u rrethue nga qindra forca malazeze. I kishin rrethue si ujku qengjat, por burrat e Mollës, me në krye Ukë Stakën e Mark Ndoun, nuk u nënshtroen. Disa ranë, por flamuri nuk ra. Në mars 1917, në Gurin e Kuq, ata u hakmorren ndaj malazezëve në ikje – një shpagim i ndershëm për një padrejtësi të madhe.

Këta fatosa s'kanë kërkuë kurrë lavdi.

Por lavdia nuk u mohohet atyne që e lanë gjakun ndër themelet e lirisë.

A sot?

Sot, kujtimet i ka përpri harresa. Shteti shqiptar, në një shekull të tanë, nuk u ka dhanë as titull dëshmori. As ceremoni për ta, as lule, as një fjalë zyrtare. Vetëm Pulti i nderon të vetët, një kujtes pjesore, me tepër spontane se sa zyrtare. Por ata nuk ishin veç të Pultit – ishin të Shqipnisë. Kurre nuk u festua një dite përkujtimore gjithë përfshirëse (Nikaj, Merturi, Shala Shoshi dhe Pultin), për te gjitha ndeshjet atij korriku historik dhe për gjithë fatosat e flijuar ne këtë muaj gjaku.

E çka kujton Shkodra zyrtare në korrik? Asgja. A pra Politika çdo vit përkujton 2 Prilli, me nderime për katër martirë të demokracisë, që u vranë në rrethana ende të errëta. Shumë mire që i nderon, ndërkohë që 120 të ranë për lirinë kombëtare, për tokën, për gjuhën, janë lanë në heshtje të plotë as nuk do te ia di askush. Kane mbi do festa tallava (festa e groshës, kërtollave, kungujve, preshit dhe leshit)

Përfundimi:

Korriku i Dukagjinit nuk asht një histori e harrueme – asht një lëmoshë që na lypet me e dhanë vetes. Jo për me rrah gjoksin para Evropës, por për me i kthye burrnisht nderin vetes sonë. Nëse nuk përkulemi para atyne që dhanë jetën pa e pasë fare shtetin, që i duhej me i nderue – atëherë jemi tue përkule kryet para pushtuesve, prapë.

Dukagjini e Shkodra s'kanë nevojë për lot e fjalime – kanë nevojë për drejtësi e kujtese. Këta emna nuk i fshin as pluhni i harresës, as shpërfillja e qeverive. Ata janë gdhendë në gurët e maleve. E guri nuk vdes.

Një memorial ky korrik e do ne mes te Shkodrës pasi forcat e Radomir Veshoviq-it dhe Kostandin Nikicit, Shkodrën kishin objektivin final, por Shkodrën nuk mund t'a gëzonin po i pre krahët Dukagjinit.

PRELE MILANI

Dy fjalë për vëllimin poetik “Pranvera po afron” të poetit Mikel Podja

Vëllimi poetik “Pranvera po afron” i autorit Mikel Podja përfaqëson një hap përpara në udhëtimin letrar të autorit, duke shfaqur një pjekuri të dukshme në stil, figuracion dhe tematikë.

Libri dallohet për lirizmin e hollë, për pasurinë e motiveve dhe për një shprehje të dukshme artistike.



1. Tematika kryesore:

- Dashuria është boshti i përmbledhjes: përjetimi i saj i çiltër, dialogët poetik të personazheve, kontrastet mes gëzimit e dhimbjes, ëndrrës e zhgënjimit. Poezitë shpesh ngjajnë si skena të vogla teatrore, të idileve dashurore, të përshkruara me sinqeritet dhe ndjenjë.

- Atdheu dhe politika: përveç motiveve lirike, Podja përfshin poezi kushtuar Gjergj Kastriotit, Kosovës, shqetësimeve për realitetin shoqëror shqiptar. Këto krijime shfaqin revoltë, thirrje për liri e drejtësi, por edhe zhgënjimin e qytetarit të zakonshëm.

- Natyra dhe peizazhi: imazhe të kthjellëta pranverore, net me hënë, çaste të bukura të përditshmërisë, që i japin freski dhe dritë lirizmit.

2. Stili dhe struktura

- Poezitë janë shkruar kryesisht me metrikë të rregullt, në strofa katërshe, me

rima të qarta e gjuhë standarde.

- Ka një figuracion të pasur, ku imazhet poetike marrin trajta të ndritshme, shpesh të mbështetura në simbole biblike, mistike apo natyrore.

- Autori kombinon lirizmin tradicional romantik me një frymë moderne, duke i dhënë poezisë edhe dimension aktual dhe shoqëror.

3. Vlerësimi kritik

Ky vëllim është një sukses i autorit, sepse dëshmon aftësinë e tij për të sintetizuar mendimin poetik dhe për të ndër-tuar një univers të pasur lirik. Pranvera po afron shihet si një ofertë estetike dhe emocionale e denjë për lexuesin. Vëllimi e pasuron poezinë shqipe bashkëkohore me një zë të qartë lirik, që gërsheton ëmbëlsinë e fjalës me forcën e mesazhit.

Zef Nika, Bruksel



MIKEL PODJA

lindur në fshatin Bene të Shllakut në vitin 1984. Mësimet e para i mori në vendlindje. Shkollimin e mëtejshëm e bëri në Shkodër. Që në rininë e hershme ka patur pasion letërsinë dhe ka bërë përpjekje të hedhë në letër mendimet dhe emocionet e tij. Tani jeton dhe punon në Gjermani. Ky është libri i tij i dytë.



Çmimi: 800 lekë

40 vite nga tragjedia e Karmës së Kirit

40 vite nga ngjarja tragjike e aksidentit të rëndë të datës 10 gusht 1985, ku shoferi K Ç. me banim në qytetin e Shkodrës, duke udhëtuar me automjetin tip "Skodë", në rrugën nacionale midis Kirit dhe Prekalit, pikërisht në Karmë të Kirit, humbi kontrollin dhe ra nga një lartësi prej 40 m, në lumin Kiri, për rrjedhojë gjetën vdekjen 27 vetë dhe mbetën të plagosur 36 të tjerë.

Historia e panjohur e ngjarjes tragjike me aksidentin e rëndë, të cilën regjimi i asaj kohe e mbajti të fshehtë dhe nuk e bëri publike, si dhe ngjarja tjetër e datës 12 mars 2007 e ndodhur në të njëjtin rrugë, (midis Kirit dhe Prekalit), në të cilën po me aksident automobilistik, humbën jetën 10 persona, duke vijuar me disa ngjarje të tjera të ndodhura më pas, po me aksident automobilistik, nga të cilat humbën jetën edhe persona të tjerë. Aksidenti në Karmë të Boksit, që humbën jetën 4 persona, me 7 Korrik 2000, duke e çuar në 51, numrin e viktimave, pa llogaritur këtu numrin e të plagosurve në këto ngjarje tragjike!

Me falenderim të thellë kujtojmë punën kolosale vetëmohuese të tre mjekëve të Spitalit Civil të Shkodrës, Ali Spahia, Ferit Hoti, Dradne Ago e të tjerë., për mjekimin e 36 të plagosurve të aksidentit tragjik të 10 gushtit 1985.

Enigmë, mbetet përse regjimi i asaj kohe, nuk i bëri kurrë publike emrat e 27 viktimave të aksidentit fatal të datës 10 gusht 1985, si dhe 36 të plagosurit e tjerë, (ku 24 viktima ishin të gjithë banorë të zonës së thellë të Dukagjinit, kurse Dodë Miri, Sulejman Hasmuja dhe Imer Ibra, ishin nga Malësia e Madhe dhe kuadro

me detyra drejtuese në Kooperativat Bujqësore të Dukagjinit, duke hedhur kështu hije dyshime mbi numrin e vërtetë të viktimave dhe të plagosurve të atij aksidenti tragjik. Por atë që nuk e bëri dot shteti i asaj kohe, pra publikimin e emrave të vik-



timave dhe të plagosurve nga ai aksident automobilistik, e bënë vetë malësorët e atyre anëve, familjarë dhe të afërm të viktimave, të cilët në vendin ku ndodhën ato aksidente (në segmentin Kir - Prekal), kanë vendosur disa gurë dhe pllaka përkujtimore tip memorialë, ku kanë gdhendur emrat e 28 viktimave të ngjarjes së 10 gushtit 1985, por edhe ato të gjashtë aksidenteve të tjera të ndodhura në 12 mars 2014, 7 korrik 2000, 8 gusht 2017, e më pas ku me 7 korrik 2023 humbi jetën në riparimin e segmentit Pog - Plan edhe

Gjelosh Rrushaj (një ndër organizatorët e Protestave të Dukagjinit për Rrugën), duke përkujtuar të 58 viktimat që humbën jetën pikërisht në Rrugën e Dukagjinit.

Pas shumë vitesh heshtje dhe mërtypje të dhimbjes nga dukagjinasi u organizuan dy protesta dhe peticioni për ti dhënë zgjidhje rrugës së Dukagjinit, që vazhdon të quhet "Rruga e vdekjes".

Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Fondin e Zhvillimit (për here të parë nga vitet 1990 e deri tani) kanë filluar rikonstrukcionin e rrugës e aksin Prekal-Kirë edhe pse rikonstrukcion theksoj që punimet nga firma janë në shumë segmente të papranueshme. Të vetëdijshëm për koston e punimeve dhe terrenin e vështirë, Dukagjini kërkon realizimin e Projektit të paraqitur.

Lusim Zotin për shpirtat e viktimave të kësaj rruge, për shëndetin e të aksidentuarve që disa edhe pse 40 vite vuajnë pasojat trupore dhe shpirtërore.

Lusim Zotin për të gjithë të lënduarit nga mos ekzistenca e një rruge normale, e cila shkaktoj dhimbje dhe braktisja të zonës së Dukagjinit. Ne numërojmë viktimat nga aksidentet, por nuk mund të numërojmë viktimat që shkaktoj kjo rrugë e amortizuar nëpërmjet së cilës shumë të sëmur u nisën për në spitalin e Shkodrës dhe si pasojë e amortizimit të rrugës dhanë shpirtë dhe u kthyen të vdekur, sa nënave ju shua ëndrra të lindnin, sepse gjatë rrugës fëmijët lindën të vdekur ku ka raste që edhe vetë nënat ndërruan jetë.

Flasim këtu për viktima dhe nuk po përmendim shkaqe të tjera që gjendja e mjerueshme e kësaj rruge të ndërtuar me aksione vullnetare, kazma, lopata e dina-

mit dhe punëtorë pa bukë në barkë "vepër e Partisë" mbolli vdekjen e Dukagjinit dhe dukagjinaseve.

Besojmë se drita jeshile e ndërtimit të kësaj rruge është ndezur dhe nëpërmjet saj Dukagjinit do ti rikthehet jeta.

Lista e emrave të 28 personave që humbën jetën në aksidentin e datës 10 gusht 1985

Nokë Nik Noka
Kol Vata
Gjovalin Kola Arrinaj
Pashkë Nikja
Shaqe Stragu
Dedë Shyti
Kozeta Mirash Vuksani
Lindita Mirash Vuksani
Nikë Kola
Mrike Palja
Mrikë Bardheci
Kin Ndoci
Gjergj Pllumi
Viktor Lulashi Ndoja
Age Marashi
Lulë Prenashi
Prekë Gjeloshi
Vuksan Preka
Mark Pali
Shaqe Nikja
Pashkë Mirja
Marie Ndoci
Pjetër Kola
Pjetër Zefi
Dodë Miri
Sulejman Hasmuja
Imer Ibra

Roza Pjetri

Dashuria për Atdheun - Diaspora si bartëse e vlerave Universale

Më 19 gusht, në sallën e Këshillit Bashkiak Shkodër, u zhvillua veprimtaria me temë "Dashuria për atdheun - Diaspora si bartëse e vlerave universale", organizuar nga Federata e Paqes Universale në bashkëpunim me Këshillin Rajonal të Paqes Shkodër.

Veprimtaria mblodhi së bashku personalitete të botës akademike, kulturore dhe shoqërore, duke vënë në qendër kontributin e diasporës shqiptare në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe në promovimin e paqes në botë.

Veprimtarinë e drejtoi zj. Majlinda La-

çaj, Kryetare e Këshillit Rajonal të Paqes Shkodër, e cila në fjalën e saj theksoi rolin e diasporës si ura që lidh shqiptarët kudo që ndodhen dhe si bartëse e vlerave universale, që forcojnë paqen dhe bashkëpunimin ndërkulturor.

Veprimtaria ngjau si një udhëtim shpirtëror nëpër rrënjët tona, një kujtesë se sa e thellë është lidhja jonë me atdheun edhe kur jemi larg tij. Diaspora shqiptare është dëshmi e gjallë se dashuria për vendlindjen nuk shuhet kurrë - ajo jeton në çdo zemër, në çdo sakrificë, në çdo përpjekje për të ruajtur gjuhën, kulturën

dhe identitetin tonë.

Veprimtarinë e nderuan me praninë dhe përshëndetjet e tyre:

Z. Defrim Methasani, Kryetar i Federatës së Paqes Universale Shqipëri

Zj. Teuta Qyteza, Nënkyetare e Bashkisë Shkodër

Z. Luigj Junçaj, ish Ministër i Pakicave Kombëtare në Mal të Zi, Ambasador për Paqe

Gjithashtu, me praninë e tyre e pasuruan veprimtarinë:

Zj. Marie Koliqi, Nënkyetare e Asamblesë së Federatës së Paqes Universale Shqipëri

Z. Kastriot Selita, Kryetar i Këshillit Rajonal të Paqes Tiranë

Programi u pasurua edhe me veprimtari artistike mjaft domethënëse: ekzekutimi plot talent, me violinë i himnit kombëtar nga Gabriela Jaku, interpretimi i perlave muzikore shkodrane nga mjeshtrit Bep Vjerdha dhe Mondi Denelli, si dhe një përmbledhje me mesazhe nga korifentë e letërsisë shqipe mbi dashurinë për atdheun, përparim nga Leandër Laçaj, përçollën emocione të veçan-

ta tek të pranishmit.

Në këtë veprimtari kushtuar figurave të shquara të diasporës shqiptare, që kanë dhënë kontribute të çmuara në zhvillimin e vendit dhe në promovimin e paqes, kulturës kombëtare dhe vlerave universale në arenën ndërkombëtare, u vlerësuan me titullin "Ambasador për Paqe"

Z. Zef Selca
Zj. Myzafere Alia
Z. Orion Çiftja
Z. Gjergj Tinaj
Z. Julian Darragjati
Zj. Dea Baba
Z. Gjergj Marena
Z. Anton Lajçaj
Zj. Eva Krypca

Kjo veprimtari shënoi një hap të rëndësishëm në drejtim të vlerësimit të figurave të diasporës dhe të thellimit të bashkëpunimit për paqe, kulturë dhe zhvillim, duke e forcuar edhe më shumë mesazhin se dashuria për atdheun është ura që lidh shqiptarët kudo në botë.

Përgatiti Majlinda Laçaj,
Kryetare e Këshillit Rajonal të Paqes Shkodër



Paketa e Maleve, ndërhyrje sociale dhe ekonomike që synon zhvillimin e zonave malore

Prof. Dr. Adrian Civici:

Dikur thuhej “T’u qepemi kodrave dhe maleve, t’i bëjmë ato pjellore si dhe fushat”. Sot janë braktisur fushat, toka nuk punohet, janë shkërrë ish- NB-të, por në skenë na ka dalë “Paketa e Maleve”. Sipas burimeve të Telegraf.al në “Paketën e Maleve” janë piketuar për t’u përvetësuar zonat më të mira turistike nga oligarkia e lidhur dhe ortakët e zyrtarëve.

Paketa e Maleve është një paketë masash dhe ndërhyrjesh politike, sociale dhe ekonomike që synon zhvillimin e zonave malore, rritjen e cilësisë së jetës së banorëve të tyre dhe frenimin e braktisjes së territoreve. Kjo iniciativë përfshin një sërë politikash publike për të përmirësuar jetesën, aksesin në shërbime dhe infrastrukturën në zonat malore. Qëllimet kryesore të Paketës së Maleve: Zhvillimi rural dhe agroturizmi; Fuqizimi ekonomik i komuniteteve malore; Përmirësimi i infrastrukturës rrugore, shkollore dhe shëndetësore; Rritja e përfshirjes sociale dhe arsimore; Nxitja e qëndrueshmërisë dhe mbrojtjes së burimeve natyrore.

Çfarë përfshin konkretisht “paketa e maleve”?

1. Subvencione për blegtorinë dhe bujqësinë malore; Nxitje për rritjen e blegtorisë tradicionale dhe përpunimin artizanal të produkteve të qumështit; Grante për përpunimin dhe ambalazhimin e produkteve autoktone.

2. Mbështetje për agroturizmin; Krijimi i strukturave të akomodimit në fshatra malorë. Lehtësira për bizneset që ofrojnë ushqim, guida apo aktivitete natyrore. Projekte për turizëm të qëndrueshëm, guida dhe rrjete turistike lokale.

Përmirësim i infrastrukturës bazë; Investime në rrugë rurale, ujësjellës, rrjet energjie dhe lidhje dixhitale; rindërtim ose rikonstruksion i shkollave, ambulancave dhe qendrave të komunitetit.

Masa sociale për të ndalur zbrazjen e këtyre zonave;

A rrezikojmë të përfitojnë oligarkët nga “paketa e maleve”? Po, rreziku ekziston, nëse mungon transparencja, monitorimi dhe përfshirja e komunitetit vendor. Si mund të përfitojnë oligarkët? Kjo për disa arsye. Ata kanë akses të privilegjuar në informacion dhe procedura; Nëse aplikimi dhe miratimi i projekteve nuk bëhet në mënyrë transparente, atëherë aktorët me lidhje politike dhe financiare kanë avantazh. “500 aplikuesit e parë” për të përfitur zero taksa për 10 vite është një kriter jo selektiv, por kronologjik – kush ka më shumë resurse, aplikon më shpejt dhe më në përputhje me kriteret. Ndërsa një banor i thjeshtë në zonat malore ka vështirësi për të hartuar projekte dhe përmbushur dokumentacionin, një oligark mund të përdorë firma konsulence, juristë dhe lidhje politike për të realizuar një aplikim “të përkryer”. Ka ndodhur që poli-



তিকat zhvillimore për bujqësinë, turizmin apo energjinë janë përdorur si kanale për përfitime private të aktorëve të fuqishëm, shpesh përmes formave “ligjërisht të rregullta”.

Si mund të parandalohet përfitimi nga oligarkët? Eksperienca shqiptare, dhe ajo e disa vendeve të tjera të BE evidenton disa masa e politika të domosdoshme “anti-oligarki”, të tilla si: Transparencë totale: Publikim online i të gjitha aplikimeve dhe përfituesve; Përfshirje e bashkive dhe komuniteteve lokale në vlerësimin dhe përzgjedhjen e projekteve; Kufizime ligjore për transferimin e pronësisë ose shitjen e investimit; Konsultim publik për çdo ndërtim në zona të mbrojtura ose historike. Përrjashtimi i kompanive me histori abuzimi apo konflikt interesi.

Ka kritika se në Shqipëri mungojnë infrastruktura, uji, kanalizimet, energjia, ilaçet, personeli mjekësor, shkollat, nxënësit, burimet njerëzore të shërbimeve etj. Me Paketën e Maleve, përfituesve, ashtu sikurse dhe investi-

torëve strategjikë të bregdetit dhe qendrave turistike do u çohen me shpenzimet e taksapaguesve, uji, energjia, kanalizimet, pa llogaritur tokën.

Kryeministri Rama ka theksuar se “Paketa e Maleve” është një program i plotë për ndihmë financiare, i orientuar drejt rikonstruksionit të shtëpive për bujtina, financimeve për turizëm malor dhe rritjes së investimeve në agroturizëm. “Për 500 aplikuesit e parë nuk do të ketë asnjë lloj takse për 10 vite”. Mesazhi për diasporën është i qartë: kthehuni, investoni në trojet e baballarëve tuaj sidomos në zonat malore investoni kursimet në Shqipëri zero taksa për 10 vjet”. Megjithatë, për këto politika e për këtë vision të Qeverisë shqiptare ka disa kritika e paqartësi që tashmë janë pjesë e debatit dhe sugjerimeve publike.

Nga një vështrim më i përgjithshëm, kritikant ndaj Paketës fokusohen në disa elementë: Mungesë e një strategjie zhvillimi të qëndrueshëm. Paketa e Maleve nuk shoqërohet me një strategji gjithëpërf-

shirëse për zhvillimin rural, siç kanë shumë vende të BE-së; Përfshirje e ulët e komuniteteve lokale në vendimmarrje; Egziston një frikë se projektet e miratuara nuk pasqyrojnë sa duhet nevojat reale të zonave malore; Mendohet se do të përfitojnë më shumë emigrantët me disponibilitete monetare, dhe jo banorët ekzistues të zonave malore, që nuk kanë shumë akses në kredi. Disa ambientalistë shqetësohen se lehtësiti në ndërtim mund të çojnë në shfrytëzim komercial të peizazheve natyrore, sidomos në zona të mbrojtura. Edhe nëse ndërtohen shtëpi apo bujtina, mungesa e rrugëve, energjisë, furnizimit me ujë, shërbimi shëndetësor e arsimor, sistemi i kanalizimeve, etj, mbeten problem për t’u parë me përparësi. Financimi dhe mbikëqyrja mbeten sfida për të garantuar që fondet të shkojnë tek përfituesit realë.

Ndoshta do të ishte mirë që projektet e bllokuara të AZHBR-së të praktikoheshin dhe shpërndareshin edhe për fuqizimin e blegtorisë në zonat malore dhe agroindustrisë së produkteve tradicionale të këtyre zonave, pasi do t’i jepej frymëmarrje bujqësisë dhe blegtorisë, e cila sot është pothuaj e falimentuar, sepse nuk ka ku ta çojë prodhimin, si qumështi, prodhimet e bulmetit, mishin, vezët, produktet e pëmtarisë, bujqësisë etj? Si e shikoni Ju zgjidhjen?!

Po, teorikisht disa projekte të bllokuara nga AZHBR mund të rikualifikohen ose riaktivizohen në kuadrin e “Paketa e Maleve”, natyrisht, nëse: Projektet janë të përputhshme me qëllimet dhe prioritetet e Paketës (turizëm malor, bujqësi e qëndrueshme, blegtori, agro-përpunim, etj.); Institucionet përkatëse (AZHBR, Ministria e Bujqësisë dhe Bashkitë) bashkëpunojnë për rishikimin teknik, rirfinancimin apo riorientimin e projekteve. Nëse ndodh një ristrukturim formal apo procedural që i lejon këto projekte të kalojnë në një linjë të re financimi apo mbështetjeje. Por, çfarë janë “projektet e bllokuara” të AZHBR? Janë projekte të financuara pjesërisht nga programet IPARD II, programet kombëtare ose skemat e subvencionimit bujqësor, që nuk janë finalizuar për shkak të mungesës së fondeve, problemeve teknike, mosplotesimit të dokumentacionit, mospërputhjes me standardet, apo mospërmbushjes së kriterëve për likuidim, apo kanë mbetur në fazën e projekt-idesë, ose me investime të papërfunduara. Çfarë ofron Paketa e Maleve në këtë aspekt? Ajo fokusohet më shumë të ndërtimi/rikonstruksioni i shtëpive tradicionale për bujtina, lehtësira për agroturizëm; investime për rrigjallërimin e ekonomive malore, rikthimi i popullsisë në zona të braktisura. Pra, nëse projekti i AZHBR-së ka qenë për ndërtimin e një bujtine, agropërpunim, blerje pajisjesh bujqësore për ferma në zonat malore, etj, atëherë ka shumë mundësi të përshtatet brenda kriterëve të Paketës së Maleve.



Portreti i Princit Lekë Dukagjinit në Fotografitë e Marubit: Realitet apo Konstruksion Artistik?



Gjon Marku

Ky punim synon të analizojë origjinën dhe natyrën e një fotografie të famshme që paraqitet si portreti i Princit Lekë Dukagjinit - një imazh që është bërë ikonë në ndërgjegjen kombëtare shqiptare. Duke shqyrtuar dëshmitë e paraqitura nga studiuesi Mark Gjon Pali, argumentohet se ky portret nuk është një dëshmi historike autentike, por një konstrukt artistik i krijuar nga Kel Marubi në fillim të shekullin XX.

Përmes këtij rasti, trajton edhe mënyrën se si arti vizual është përdorur për të mitizuar figura historike, sidomos në mungesë të të dhënave burimore. Krahas kësaj, trajtohet përmasimi real historik dhe juridik i Princit Lekë Dukagjinit përmes Kanunit, si një ndër veprat më të rëndësishme të të drejtës tradicionale Shqiptare.

Në historiografinë dhe kulturën shqiptare, Princi Lekë Dukagjini zë një vend të rëndësishëm jo vetëm si bashkëkohës i Gjergj Kastriotit, por sidomos si figura që identifikohet me Kanunin - një përmbledhje e të drejtës tradicionale, që për shumë kohë ka rregulluar jetën shoqërore të shqiptarëve. Në dekadat e fundit, një fotografi që paraqitet si "portreti i Lekë Dukagjinit", realizuar nga Kel Marubi, është bërë pjesë e këtij identiteti.

Në publikime të ndryshme, nga libra akademikë e deri të rrjetet sociale, qarkullon një fotografi e emërtuar si portreti i Lekë Dukagjinit, e realizuar nga Kel Marubi (1870-1940). Fotografia mbart mbishkrimin "Princ Lekë Dukagjini" dhe pranohet shpesh pa verifikim si një paraqitje reale historike.

Mirëpo, fotografia si medium u shpik shumë kohë pas vdekjes së Lekë Dukagjinit (vdiq më 1481)¹, ndërsa fotografia e parë në botë u realizua në vitin 1826-1827². Prandaj lind pyetja: mbi çfarë baze u krijua kjo fotografi?

Por le të synojmë të hedhim dritë mbi origjinën e këtij imazhi, vlerën e tij si dokument artistik dhe mënyrën se si ai është integruar në kujtesën kolektive si simbol i identitetit kombëtar.

Sipas të dhënave të paraqitura nga Mark Gjon Pali (Ilirikum, 2003)³, fotografia në fjalë nuk është realizuar mbi ndonjë burim vizual autentik të shekullit XV, por është një krijim i vetëdijshëm artistik nga Kel Marubi. Ai mbështetet në një pikturë

të vitit 1826, që paraqet Zef Lek Palin, pikturuar nga Giuseppe De Paoli. Marubi modifikon këtë portret për t'ia atribuar Lekë Dukagjinit:

- I shtoi një qeleshe shqiptare,
- I zgjati mustaqet,
- E paraqiti me armë në brez,
- Në dorën e majtë i vendosi një letër të mbështjellë me mbishkrimin "KANUNI" - duke e portretizuar si themelues dhe mbrojtës të ligjeve zakonore shqiptare⁴.

Kjo ndërhyrje vizuale shërben për të krijuar një identitet vizual që nuk ekzistonte më parë për figurën e Lekës, por që u pranua shpejt nga opinioni publik dhe më vonë u përhap nëpërmjet kartolinave si një simbol kombëtar.

Piktura për të cilën flitet, mbante mbishkrimin:

"Këtë Simon Batta e punoi më 5 nëntor 1826 në Venecie".

Më pas, u mor nga Lezja e Gjon Palit kur u martua me Frano Lufin dhe ruhet si një relike familjare⁵.

Interesant është edhe fakti që Zef Lek Pali, përkteu veprën e Dantes në shqip -ndërsa disa gabimisht ia atribuojnë këtë djalit të tij, Kol Zef Palit. Kjo gabimësi është korrigjuar në Buletinin Shkençor të ILP, Shkodër, viti XII, nr. 17⁶.

Tonin Çobani në veprën "Princi i përfolur"⁷ e quan këtë portret një "apokrif", duke vënë në dukje se pamja fizike që i është dhënë Lekës është më shumë një refleksion i idealeve të një udhëheqësi humanist të shekulli XV - në stilin e Lorenzo de' Medici apo Federigo Montefeltro - personazhe të një kohe e kulture që mishëronin dijen, urtësinë dhe vizionin strategjik.

Ky krahasim nuk ka për qëllim idealizimin, por rikontekstualizimin e Lekës në një hapësirë kulturore që shkon përtej stereotipit të "malësorit" dhe e vendos atë si një figurë të rëndësishme të mendimit dhe drejtësisë tradicionale shqiptare.

Pavarësisht se figura e Lekës si portret vizual mund të jetë e ndërthurur, trashëgimia e tij përmes Kanunit është një realitet historik dhe juridik me peshë të jashtëzakonshme. Kanuni, i kodifikuar nga At' Shtjefën Gjeçovi⁸, përfaqëson një sistem të sofistikuar të së drejtës tradicionale, që rregullonte jetën shoqërore, marrëdhëniet mes njerëzve dhe normat e nderit, faljes dhe drejtësisë.

Studiues si Eqrem Çabej, Anton Çetta,

Edith Durham dhe Franz Nopcsa e kanë vlerësuar Kanunin si një kontribut të veçantë në trashëgiminë juridike dhe kulturore të Evropës Juglindore.

Pika themelore të Kanunit përfshijnë:

- Parimi i paprekshmërisë së jetës njerëzore;
- Roli i kuvendit dhe pleqve si instanca gjyqësore kolektive;
- Falja si virtut i burrërisë dhe urtësisë.

Kanuni nuk ka qenë asnjëherë një ligj i dhunës pa kritere; përkundrazi, ai është sistem i rregullave të ndërlikuara dhe i mbrojtjes së nderit dhe bashkësisë, me theks të qarta etike.

Në ditët tona, për fat të keq, Kanuni shpesh përmendet në kontekste të dhunshme dhe justifikuese për hakmarrje të verbër, sidomos ndaj grave apo fëmijëve. Këto janë keqinterpretime të rënda, të cilat nuk bazohen në tekstin autentik të Kanunit. Kumtesa thekson nevojën për

një strukturë që i afrohet etikës homerike dhe thotë:

"Shoqëria pa ndonjë autoritet shtetëror e shndërron dhunën e hakmarrjes në një forcë të shenjtë - por vetëm për ta kontrolluar dhe zbutur atë."

Këta studiues në tërësi e kanë parë Kanunin si model të organizimit etik dhe shoqëror në kushte të mungesës së shtetit. Krahasimi që bëjnë me etikën homerike apo rendin tribal të kulturave të lashta, dëshmon për vlerën antropologjike të këtij sistemi.

Sot, Kanuni shpesh keqinterpretohet dhe abuzohet, sidomos në media, ku përdoret si justifikim për krime që në të vërtetë bien ndesh me frymën e tij. Kanuni nuk urdhëron vrasje për fjalë goje, nuk lejon vrasjen e grave e fëmijëve, nuk legjitimon hakmarrjen pa rrugë të faljes.

Rasti i portretit të Lekë Dukagjinit tregon qartë se arti dhe imazhi mund të

marrin rol mitik, sidomos kur figura të rëndësishme kombëtare paraqiten pa burime autentike. Por nëse ky portret nuk ka vlerë si dokument historik, por një përfytyrim artistik me funksion simbolik..

Një simbol që bashkon një figurë reale me një nevojë kolektive për përfaqësim: të urtisë, të ligjit, të krenarisë kulturore. Ndaj, më shumë se një imazh, ky është një kujtim i përfytyruar, i cili mbetet i vlefshëm vetëm nëse e kuptojmë për atë që është: një konstrukt artistik që frymëzohet nga një trashëgimi e gjallë.

Megjithatë, përmes këtij imazhi dhe identifikimit me Kanunin, Lekë Dukagjini ka hyrë në kujtesën kolektive si figurë përfaqësuese e drejtësisë, urtësisë dhe krenarisë kombëtare.

Kanuni i Lekë Dukagjinit mbetet një vepër monumentale e mendimit juridik shqiptar, një dëshmi e gjallë e organizimit shoqëror autokton dhe një trashëgimi që meriton të


studiohet dhe të kuptohet drejt - larg mi-teve, por afër vlerave që përfaqëson.

Literatura

1. Vdekja e Lekë Dukagjinit daton me 15 qershor të vitin 1481. Data e lindjes mbetet e panjohur.

etj.etj... etj.....

Studiuesi e publicisti
GJON MARKU



një qasja edukative në shkolla dhe institucione, në mënyrë që vlerat reale të Kanunit të mos deformohen nga lajme sensacionaliste apo praktika arkaike.

Kanunin e kanë studiuar gjerësisht edhe dijetarë ndërkombëtarë. Jacob Burckhardt⁹, Walter Peinsipp¹⁰, Franz Nopcsa¹¹, Edith Durham¹² dhe më vonë Prof. Kazuhiko Yamamoto¹³ e kanë cilësuar Kanunin si një nga shembujt më të rrallë të së drejtës tradicionale të ruajtur në Evropë. Yamamoto e përshkruan atë si

Humanisti i shquar shqiptar dhe bashkëpunëtor i afërt i Gjergj Kastriotit

ARQIPESHKVI PAL ENGJËLLI (1417 - 1470)



Prof. dr. Mikel Prennushi

Në plejadën e humanistëve të shquar shqiptarë të shekujve XV, XVI, një vend të merituar ka Imzot PAL ANDREA ENGJËLLI nga familja e njohur e Engjëllorëve, dukë të Drishtit, familje e njohur patriote që luajti një rol me rëndësi në mesjetën shqiptare e sidomos në periudhën e Gjergj Kastrioti. Kjo familje me titull fisnikërie kishte lidhje të ngushta me familjet kryesore princërore shqiptare të kohës. Pal Engjëlli jetoi e veproi në epokën e Gjergj Kastriotit si prelat fetar e si humanist i përmendur dhe diplomat i shtetit të përqendruar arbëresh të kësaj kohe. Pothuajse bashkëmoshatar me Heroin Kombëtar, ai qe njëheri edhe mik i tij, (ata te dy ishin djem tezesh – nenat motra, shënim i Dr. Mark Palnikaj)⁶, siç pohon disa herë Marin Barleti në veprën e njohur “De vita et Gestis Scanderbeghi, Epirotarum Principis” Roma 1508 - 1510, qe këshilltar dhe diplomat i tij.

Pal Engjëlli lindi në 1417 dhe vdiq rreth viteve 1469 - 1470. Ai qe arqipeshkëv i Durrësit. Në kryeveprën e tij kush-tuar Gjergj Kastriotit Marin Barleti jep këtë karakterizim për Pal Engjëllin: “Ky kryepeshkop qe epirot, nga kryeqyteti i Drishtit, bir i Andrea Engjëllit për të cilin folëm më lart, burrë i pajisur me mendje shumë të lartë e me zotësi të rallë në të folur (në gojtari), me dituri si askush dhe i vaditur në letërsinë e shenjtë dhe në letërsinë humane, si greke ashtu dhe latine, sidomos i shquar për rreptësi në jetë e zakone... burrë që Skënderbeu e mbajti mbi krye për maturinë e tij, kulturën e pastërtinë e jetës, burrë që e respektonte dhe e dëgjonte si ndonjë orakull të gjithë epirotët dhe arbërit...” (M. Barleti “Historia e Skënderbeut” T, 1964, fq. 395, 430).

Imzot Pal Engjëlli është i njohur sepse prej tij kemi të shkruar në gjuhën shqipe “Formulën e Pagëzimit”, të parin dokument të gjuhës shqipe të shkruar. Është viti 1462, duke u gurmuar në bibliotekën Laurentiana të Firencës, dijetari rumun Nikolae Jorga e gjeti këtë frazë në gjuhën shqipe dhe e botoi më 1915 në veprën e tij

“Notes et extraites pour servir à l’histoire des croisades au XV siècle” (Bukuresht, 1915, f. 195).

Në udhëzimet e porositë që Pal Engjëlli, me cilësinë e kryepeshkopit të Durrësit, i jepte klerit të dioqezës së Lisit në Mat, ku shërbente peshkop Andrea, ndër 37 fletët në pergamenë që përmbante ky dokument në gjuhën latine (formati i fletëve 20 x 14 cm), dijetari rumun gjeti dhe dy radhë të shkruara në gjuhën shqipe me alfabet latin: “Unte’ paghesont peremnit Atit et Birit et Spertit Senit”. Këto radhë janë shkruar në faqen 4 (në krye) të këtij dorëshkrimi latin. Duke lexuar këtë raport të Pal Engjëllit mësojmë se ai si kryepeshkop kishte mbledhur gjithë klerin e dioqezës së Matit në kishën e Shën Trinisë, më 8 nëntor 1462 dhe se atje ndër udhëzime të tjera i jepte porosi klerit që prindërit në mungesë të priftërinjve mund t’i pagëzonin fëmijët e tyre me këtë formulë duke u hedhur pakëz ujë mbi krye. Dihet se dioqeza e Matit varej nga Ipeshkvia e Durrësit dhe se në Mat janë mbajtur në atë kohë shumë kuvende kishtarë. Formula e shkruar në shqip dhe e përdorur në ritet fetare të kohës tregon një shfaqje të gjallë të patriotizmit nga vetë Pal Engjëlli dha nga vartësit e tij. Jemi në kohën e luftërave fitimtare të Skënderbeut kur heroi ynë kombëtar quhej në dokumente “DOMINUS ALBANIAE” - Zot i Arbërit.

Në Bibliotekën Laurentiana të Firencës ky raport i shkruar nga dora e Pal Engjëllit në 37 fletë, mban numrin e inventarit 1167 dhe ruhet si një ndër dokumentet e çmuara të kësaj biblioteke të kohës së Rilindjes Europiane. Në vitet 60-të të shekullit XV, Pal Engjëlli, si diplomat e këshilltar për punët e jashtme i Gjergj Kastriotit, qe aktivizuar shumë. Ai e shoqëroi Skënderbeun në vizitën katërditore që bëri në Raguzë (Dubrovnik) dhe në Itali më 1461.


Dihet historikisht se Republika e Raguzës pati marrëdhënie të mira me Gjergj Kastriotin gjatë gjithë kohës që Shqipëria kalonte provën e rëndë të ballafaqimit luftarak me forcat e pushtuesve osmanë. Në Raguzë, fjalimeve mburrëse të udhëheqësve raguzanë për Skënderbeun dhe popullin e tij, Pal Engjëlli, siç na tregon Marin Barleti, iu përgjigj paralelisht me një oratori të rrallë, duke lavdëruar zhvillimin kësaj republike dalmate, shkencën humaniste dhe artet që atje kishin lulëzuar. Ndër të tjera në fjalimin e tij ai tha: “... Këtu në Raguzë lulëzojnë të gjitha artet e lira, filozofia, teologjia, shkenca e ligjeve dhe disiplinat e tjera... Unë ju jap

fjalën e zotohem se për të mirat që na keni bërë, kujtimi juaj, emri juaj dhe i qytetit tuaj do të jenë përgjithmonë të nderuar sa të rrojë Epiri, do të jenë ngulitur thellë në shpirt, në mendjet dhe zemrat tona”. Vërtetë se kjo pjesë e fjalimit të Pal Engjëllit është krijim i penës mjeshtërore të Marin Barletit, po dihet gjithashtu mirë fort se në farkëtimin e miqësisë mes Raguzës dhe shtetit të Arbërit, një rol me rëndësi ka luajtur Pal Engjëlli. Natyrisht të dy shtetet fqinje ishin të interesuara për një bashkëpunim në luftat mbrojtëse kundër hordhive osmane. Dihet gjithashtu se Pal Engjëlli qe një humanist dhe konsiderata e tij për lëvizjen humaniste përparimtare të njerëzimit qe e madhe.

Imzot Pal Engjëlli, si diplomat, u përpoq të afroje shtetet e interesuara në aleancën kundërosmane. Shqipërisë në atë kohë i interesonte të kishte marrëveshje e aleanca me Raguzën, Hungarinë, Venedikun dhe me vende të tjera. Në këtë drejtim përpjekjet nuk munguan, e sidomos nga ana e Pal Engjëllit. Autoritetin e tij fetar e shfrytëzoi plotësisht në dobi të atdheut. Kështu, si shoqërues i Skënderbeut në vizitën në Itali më 1461, ai u tregua i shkathët në marrëveshje me mbretërinë e Napolit, me Papatin dhe në takime me princër të tjerë. Gjithashtu edhe Traktati i Gaeta - s është vepër e Pal Engjëllit (1461). Shteti i përqendruar i Arbërit nën ud-

hëheqjen e Skënderbeut kishte nevojë për ndihma materiale e morale, kishte nevojë për aleatë në luftën e pabarabartë kundër pushtuesve osmanë që derdheshin çdo vit kundër kështjellave tona me sulmet e tyre të tërbuara.

Më 1464, Pal Engjëlli, si i dërguar i posaçëm i Skënderbeut, kreu një mision diplomatik pranë kontit Sforza të Milanos. Në letër kredencialet e paraqitura shprehet qartë misioni i tij i rëndësishëm në kërkim të një aleance dhe të ndihmave materiale. Skënderbeu, siç na e tregon dhe Fan Noli, kishte pasur letërkëmbim me kontin Sforza që në vitin 1461. Siç duket, misioni diplomatik i Pal Engjëllit pati sukses fillimisht, po më vonë nuk dihet përse ndihma materiale për Shqipërinë trime qe reduktuar. Pikërisht në ditët kur Pal Engjëlli ishte në Milano, humanisti i shquar italian, Françesk Filelfo u drejtonte letra princërve italianë si dhe dogjës së Venedikut, Kristofor Maurit, në të cilat shpreh gjithë simpatinë dhe përkrahjen për luftën e drejtë që bënin shqiptarët. Përmbajtja e letrave lë të kuptohet se Pal Engjëlli e ka takuar edhe Françesk Filelfon, njëri me influencë dhe humanist i përmendur. Në letrat e tij Filelfo shkruan: “Skënderbeu është shpirtmadh dhe i stërvitur në mes të turqve që në moshë të re... Pas tij janë shumë kalorës dhe këmbësorë shqiptarë nga më trimat. Midis gjithë



kombësive të tjera ndërmjet Danubit e Adriatikut dhe kufijve të Italisë, shqiptarët qenë të vetmit që u bënë ballë turqve me trimëri të madhe...” Dhe më poshtë: “Skënderi pra, do të ketë mundësi të japë një kontribut jo të vogël në çështjen tonë të përbashkët... Fuqive të tij do t’i vinë në ndihmë dhe fuqitë ushtarake të Kontit Sforza, të këtij princi trim e të përmendur...” Pal Engjëlli diti të mbrojë drejt çështjen shqiptare dhe të bëjë përkrahës edhe në principata të tjera të Italisë. Nuk duhet të na habisë fakti që një kryepeshkop luan kaq mirë rolin e një diplomati. Në Mesjetë, klerikë, shkencëtarë, shkrimtarë kryenin këto detyra duke përfutur nga prestigji që gëzonin, gojëtaria dhe mençuria. Kështu, në Mesjetë edhe Dante e Bokaçio qenë ambasadorë, po ashtu si matematikani e stronomi shqiptar, Gjon Gazulli, presbiter, (prift i nderuar) që për disa vite sherbeu si i dërguar i posaçëm i Skënderbeut në Republikën e Raguzës, radhazi me vëllezërit e tij Pali dhe Andrea. Në dokumentet e kohës: “Johannes Gini Gazulo, artium doctor, astronomus praeclarissimus (Gjon Gjin Gazulli, doktor i shkencave dhe astronom shumë i çmuar) që edhe profesor i Universitetit Al’Bo’ të Padovës. Pal Engjëlli që diplomat i Skënderbeut edhe në marrëdhëniet komplekse e të vështira me Republikën e Venedikut. Këtë e dëshmon edhe një marrëveshje e datës 13 shtator 1465, në të cilën Pal Engjëlli nënshkruan “në emër të madhnueshmit Skënderbe” si dhe konsultimet e shpeshta e të herëpashershme që bëri Skënderbeu me të lidhur me marrëdhëniet me Venedikun.

Duke punuar me ngulm, mençuri e atdhetarizëm për një politikë të jashtme sa më aktive në dobi të çështjes kombëtare, Pal Engjëlli nuk harron asnjë çast se buri mi kryesor i forcës shqiptare qëndronte në bashkimin e popullit të të gjitha krahinave nën udhëheqjen e Skënderbeut, nën një komandë të vetme e të drejtë. Prandaj në fjalimet e tij para popullit ai mburri kurdoherë këtë figurë kryesore të qëndrësës shqiptare. Në një nga fjalimet e tij para luftëtarëve shqiptarë, sipas Marin Barletit, Pal Engjëlli më 1461 tha këto fjalë për kryetrimin e atdheut tonë:

“Fatbardha dhe fort të lumtura janë ato republika, mbretëri e shtete, që qeverisen nga njerëzit më të mirë dhe më të ditur... Në kohën e sotme ne e shohim qartë si drita, se këtë fat e kanë pasur Arbërit tanë, të cilët qeverisen nga Skënderbeu, i vetmi princ aq i ditur, aq i mirë dhe kapidan i pathyeshëm...” Këto fjalë tregojnë konsideratën e lartë të Pal Engjëllit për Skënderbeun. Ata ngjallën besimin e krenarinë e popullit për këtë figurë politike e ushtarake, për këtë njeri me virtyte të larta, simbol i popullit të vet. Me autoritetin e tij kishtar Pal Engjëlli u përpoq të realizojë dhe bashkimin e koherencën mes princërve shqiptarë nën udhëheqjen e Skënderbeut. Një vepër e mirë e tij është sidomos ajo që, me përpjekje e maturi, më 1459 pajtoi mes tyre princërit dukagjin me Skënderbeun, duke shmangur një përçarje mes radhëve të shqiptarëve apo një gjakderdhje të kotë.

Nuk ka dyshim se në politikën e jashtme të shtetit arbër, në shekullin XV, një rol të rëndësishëm ka luajtur Imzot Pal Engjëlli si një i ditur, i kulturuar dhe i be-

suar i Skënderbeut, si prelat kishtar që me autoritetin e prestigjin e tij ndikoi me atdhetarizëm në ngjarjet e kohës.

Ai është figura e diplomacisë shqiptare së kësaj periudhe që shënoi një epokë dhe diplomati i parë shqiptar që njohim deri tani.

Pal Engjëlli, si figurë historike, atdhetare e humaniste i atribuohet dhe një meritë tjetër. Mendohet se ai është autori i një historie të Skënderbeut në gjuhën latine e botuar në Venedik më 2 prill 1480, pra gati 30 vjet para veprës së Marin Barletit. Për herë të parë dhe i vetmi që e shfrytëzoi këtë vepër është historiani italian G. Biemmi, i cili botoi më 1742 në Breshia (Brescia) “Istoria di Giorgio Scanderbegh”. Ai pohon se historinë e Skënderbeut të vitit 1480 e gjeti në një bibliotekë dhe e shfrytëzoi gjerësisht për veprën e tij, ashtu si dhe vepra të tjera, si atë të Barletit dhe të shumë autorëve të huaj mbi Skënderbeun. Vetë Biemmi na e jep titullin e kësaj vepre, titull të cilin e gjeti në fund të librit, meqenëse fletët e para qenë të grisura: *explicit Historia Scanderbeghi, EDITA PER QUONAM ALBANENSES...* (Këtu merr fund Historia e Skënderbeut, botuar prej një shqiptari...) Meqenëse autori mbeti anonim, Biemmi e quajti “Antivarino” apo në gjuhën shqipe “Tivaresi”. Biemmi na thotë edhe se Tivaresi e shkroi historinë e Skënderbeut edhe mbi bazën e dëshmimeve të vëllait të tij, i cili shërbeu si oficer në gardën e Gjergj Kastriotit. Duke marrë parasysh këto të dhëna si dhe të tjera, historiani ynë i njohur Fan Noli, me të drejtë mendon se ky autor anonim nuk ka kush të jetë tjetër veçse Pal Engjëlli. Historiani gjerman Franz Babinger e ndonjë tjetër, pa u thelluar, e kanë menduar historinë e Skënderbeut të vitit 1480 një shpikje të Biemmit, po kjo kundërshtohet me të drejtë se kjo histori ka të dhëna e datime më tepër se ajo e Barletit dhe se më vonë këto të dhëna janë vërtetuar nga dokumentacioni, se kjo histori është një burim i pavarur, se ajo është më realiste e me një vështrim më kritik se veprat e tjera dhe së fundi, një gjë të tillë Biemmi nuk kishte arsye të bënte. Duke arsyetuar mbi këtë çështje, domethënë mbi autorësinë e veprës dhe arsyetuar se kjo vepër është shkruar nga Pal Engjëlli, sepse prej një njeriu të ditur si ky mund të pritej një vepër e tillë, se Engjëllorët vërtetë kanë qëndruar në Drishti, po në zotërimin e tyre ka qenë Tivari dhe se Pal Engjëlli, kryepeshkopi i Durrësit, kishte vërtetë një vëlla të tij, Pjetër Engjëllin, oficer të gardës së Gjergj

Kastriotit dhe pikërisht ai duhet t’i ketë shërbyer me të dhëna të sakta për luftimet kundër osmane e ngjarje të tjera nga balli i përgatitjeve për luftë. Më në fund, duhet të themi se Pal Engjëlli dhe i vëllai, Pjetër Engjëlli, vdiqën në mërgim, në Itali dhe vepra ka mundësi të jetë shkruar në periudhën e mërgimit dhe të jetë botuar në Venedik, pikërisht aty ku bashkë vëllezëria shqiptare (Confraternità albanese) e asaj periudhe kishte krijuar një vatër të kulturës shqiptare. Të kujtojmë Barletin, Biçikemin, Karpaçin e viganë të tjerë të mendimit e të artit humanist shqiptar dhe të Rilindjes evropiane. Dy studiues të huaj, të mirë informuar, të kësaj periudhe e që kanë shkruar vepra me vlerë si, Johann Fallmerayer dhe Hof (Hoph), kanë pohuar se Lukari, analist i mirënjohur raguzan, në veprën e tij “Analet e Raguzës”, shprehet qartë se kryepeshkopi i Durrësit ka lënë një vepër të shkruar për Skënderbeun. Është fakt se Pal Engjëlli ka vdekur më 1469 dhe se vepra mbi historinë e Skënderbeut u shtyp më 1480, po kjo nuk përjashton mundësinë që dorëshkrimi i tij të jetë botuar si vepër postume (pas vdekjes). Pikëpyetja kryesore mbetet te vepra e Tivarasit (apo Pal Engjëllit), që nuk është gjetur deri sot. Në kohën kur u botua kjo vepër shtypshkrimi në Venedik, po dhe në mbarë botën, ishte në hapat e para. Kjo nuk është e para vepër incunabula (kështu quhen veprat e botuara nga fillimi i shtypshkrimit e deri në 1500) që ka humbur. Sidoqoftë ne mbështetemi tek studimet e thelluara të Fan Nolit dhe shpresojmë të vërtetohet një ditë vepra dhe autori.

Të gjithë janë të mendimit se prej Imzot Pal Engjëllit pritej një vepër e tillë për Motin e Madh shqiptar dhe kryetrimin e arbërve, Skënderbeun, sepse ai që një ndër bashkëpunëtorët e afërt të heroit, mik, shok e bashkëmohatar me te. Ai më mirë se asnjë bashkëkohës i tij, me erudicionin, me atdhetarizmin, me idetë humaniste, mund të shkruante këtë vepër në kujtim të atyre ngjarjeve të mëdha që përjetoi Arbëria, një vepër për brezat që do vinin.

Autor i dokumentit të parë të shkruar në gjuhën shqipe, diplomat, atdhetar, humanist i njohur, Imzot Pal Engjëlli si bashkëpunëtor e bashkëluftëtar i Skënderbeut për çështjen shqiptare ka një vend të merituar në historinë religjioze e kulturore të atdheut.

Imzot Pal Engjëlli ka luajtur një rol të rëndësishëm në marrëdhëniet e Shqipërisë së kohës së Skënderbeut me Papatin, dhe konkretisht me Papët, Nicola V (1447 - 1453) humanist i përmendur, Ka-

listi III (1453 - 1458), Pio II (1458 - 1464) dhe Paolo II (1464 - 1471), gjatë pontifikateve të tyre.

Enea Silvio Piccolomini, humanist i shquar që më vonë u bë Papë, e çmoi shumë humanistin Pal Engjëlli si prelat fetar dhe humanist. Dihet historikisht se ky Papë (Pio II) që nisur për Shqipëri për t’i ardhur në ndihmë Skënderbeut dhe kishte ndërmend të kurorëzonte Heroin Kombëtar mbret të Shqipërisë. Por dihet se Papa Pio II, gjatë rrugës për në Shqipëri, vdiq në Ankonë më 15 gusht 1464.

Bibliografia


1. M. Barleti. “Historia e Skënderbeut”, Tiranë, 1964 (përkthim. prof. Stefan Prifti) fq. 395, 396, 397, 430, 467.
2. N. Jorga. “Notes et extraites për servir à l’histoire des croisades au XV siècle”, Bukuresht, 1915, fq. 195.
3. Fan S. Noli “Historia e Skënderbeut”, Tiranë, 1967, fq. 245, 251, 270, 120, 159, 170; George Castrioti Scanderbeg (1405-1468) by Bishop Fan Stylian Noli Ph.D., International Universities Press, New York, 1947.
4. Giammaria Biemmi. “Istoria di Giorgio Castrioto Scanderbegh, Brescia, Giam. Battista Bissimo, 1742 (Biblioteka e Muzeut Shkodër).
5. M. Barlezio “De vita et Gestis Scanderbeghi Principes, Romae 1508 - 1510. (Biblioteka e Universitetit Shkodër).

6. Mark Palnikaj: A thua e kishte gabim ai që shkroi se Pal Engjëlli është kushëri i Gjergj Kastriotit? Lexojeni! “(Dekret i përgjithshëm i shenjtërisë, zotit tonë Papa Piu II, Papë për provani hyjnore, i lëshuar me kërkesën e shumë të nderuarit dhe shumë të ndriturit kardinalit të Kishës së Shenjtë Romane dhe zotit kryepeshkëv të Durrësit, zotit Pal Engjëllit dhe kundër sektit muhamedan dhe në të mirë të mbretit të pathyeshëm të Arbërisë, zotit Skënderbe, kushëritit të shumë të ndriturit zotit Pal dhe sikurse duket sheshit nga vula e vënë poshtë).

Më duhet të ju shpjegoj se ky dokument ruhet në Bibliotekën Laurenciana të Firences. Në Arkivin Sekret të Vatikanit në treguesin alfabetik të emrave nuk figuronte emri i Pal Engjëllit. Ja u kërkova me insistim punonjësve të arkivit që të më gjenin së paku Bullën Papale të Papa Piu II për dekretimin e Pal Engjëllit si Kryepeshkvi i Arkipeshkvisë së Durrësit dhe as këtë nuk ma gjetën edhe pse në Librin e Konrad Eubelit Hierarchia Cattolica Vol II shënohej qartë dekretimi i këtij Arkipeshkvi. Më vunë në dispozicion disa nga dosjet e Papa Piu II të dytë, por atë që kërkova unë nuk qe e mundur të gjendet. Kërkimet vazhdojnë...

(Shënim i autorit: Në librin tim “Kontribut shqiptar në Rilindjen Evropiane” Tiranë 1980, mungojnë humanistët Imzot Pal Engjëlli dhe prifti nga Drishti Dhimiter Frangu, historian i Skënderbeut. Me botimet që po i bën “Phoenix” këtyre dy figurave, plotësohet edhe kuadri i kësaj trajtese).

Paraqiti për botim Dr. Mark Palnikaj



Misioni i shkollës dhe “kushtetuta profesionale” e mësuesit!

Në prag të fillimit të vitit të ri akademik

Mësues mund të të behën plot në jetë, po mësuesi më i mirë është vetë jeta jote
(Nasho Jorgaqi)



Fran Gjoka

Besoj se është momenti i duhur, kur shkollës, strukturës, rolit dhe funksioneve të saj duhet t'i kushtojmë kujdes të veçantë, sidomos në këto momente të vështira të transformimeve dhe efekteve kaotike të tranzicionit social. Bindja e patundur se shkolla është institucion me rëndësi i formimit qytetar dhe i sigurisë morale, na detyron të gjithë prindër dhe mësues, politikanë dhe intelektualë që të investojmë më shumë për shkollën si institucion, por dhe për mësuesin si figurë qendrore e universale e saj. Pa mësues e drejtues shkollë që dinë vlerën e këtij institucioni dhe bashkë me të edhe misionin e figurës dhe personalitetit të tyre profesionalisht dhe etikisht e qytetarisht dominant, kjo nuk ka për të qënë e mundur. Ne jemi në një moment shumë delikat të ngadalsimit total të reformave që ka sjell edhe mungesën e kualifikimit të mësuesve e drejtuesve të shkollave që po ndikon negativisht në efektet e duhura të shkollimit që po ndikojnë herë pozitivisht dhe herë të tjera jo ashtu si duhet për të ndërtuar ekuacionin modern që sinkronizon dhe sintetizon objektivat makro të shoqërisë me efektet e duhura të shkollimit. Në këtë kontekst, shkolla, si institucion i specializuar, kërkon doemos mësues e drejtues me një autoritet e profesionalizëm të dukshëm. Ky është kushti i parë, mbase më kryesor, që rrit forcimin cilësor në shkollat tona. Çfardo që të ndodhë, sado e modernizuar që të bëhet shkolla, ato nuk mund të spostojnë në asnjë rast rolin e mësuesit si mjeshtër i procesit të edukimit modern dhe “agent elokuent” i sigurimit të ndërveprimeve dhe rolit të mësimit dhe shkollës në aspektin pedagogjik, shoqëror e kulturor. Mësuesi është figura individuale e mësimit si proces i përvetësimit të dijeve dhe i shkollës si institucion i edukimit qytetar të nxënësve. Pozicioni i privilegjuar i mësuesit, vendosja graduale e tij në qendër të mësimit dhe edukimit, është i lidhur me rolin, misionin dhe

detyrën e veçantë që ai ka në procesin e mësimit dhe të shkollës. Pozicioni aktual i mësuesit në shkollë dhe roli i tij mësimdhënës dhe edukues është i lidhur me disa cilësi intelektuale volitive, emocionale dhe morale të personalitetit të tij, që konsiderohen si kusht i domosdoshëm që t'i bëjnë ata të quhen mësues me autoritet e profesionalizëm të përkryer. Dhe mësuesi pa autoritet, ose me autoritet të kufizuar, është një nga pengesat, në mos më kryesor, që pengon shkollën tonë në rrugën e saj të shpejtë të progresit profesional e demokratik. Është e rëndësishme të flitet për një etikë të mësimdhënies, mbasi mësuesi “bëhet ligj” në drejtimin e veprimeve të nxënësve veçanërisht të moshave të vogla, ku akoma nuk është formuar plotësisht arsyeja. Rastis shpesh që të dëgjojmë një fëmijë të vogël të thotë mbi një argument “e ka thënë mësuesi” dhe është i gatshëm të mbrojë mendimin e mësuesit dhe në se babai ose nëna mund të thotë të kundërtën. Kjo ndodh në se mësuesi bëhet domethënëns për fëmijën dhe ka autoritet mbi të. Njoha me nxënësin është hapi i parë që çdo mësues duhet të bëjë. Këtu kujtoj një thënie të pedagogut Martin Buber: “Është e vërtetë që më duhet të hap librat dhe të lexoj, por e bëj këtë vetëm nëqoftëse, sapo të mbyll librin e ngre sytë, para meje ndodhet personi të cilin duhet ta edukoj”. Koha është tejet dinamike nga njohuritë, detyrat dhe objektivat që ka shkolla. Kryesore është që të ndryshojmë stilin e komunikimit, duke mos u ndalur thjeshtë tek detyra për të patur në klasë një “nxënës reagues”, por synimi aktual është që nxënësit të bëhen proaktivë. Kjo do të thotë që në bazë të shkollës, punës mësimore dhe edukative, duhet të këtë një “kushtetutë lidhëse” midis interesave të nxënësit dhe ndikimit të mësuesit. Në këto kushte detyrimisht lind nevoja e qëndrimit dialogues që duhet të mbajmë me brezat që na janë besuar t'i mësojmë e edukojmë. Në këtë rast edukimi nuk është i njëanshëm, por i dyanshëm: edukuesi dhe i edukuari pra, nxënësi dhe mësuesi. Problemi që ka shkolla në këtë aspekt, problemet dhe konfliktet që e shqetësojnë atë, na detyrojnë të mëndojmë se një pjesë e mësuesve, për shkaqe të natyrave të ndryshme, nuk kanë aftësitë, njohuritë psicosociale të komunikimit dhe këshillimit psikopedagogjik. Ne besojmë se është momenti për t'i parë gjërat më me kujdes dhe përgjegjësi. Sidomos atë që ka të bëjë me raportin shumë delikat midis rolit të ri të shkollës dhe “misionit të vjetër” të mësuesit. Kështu mësuesi lirohet nga gjithëpushtetësia që mund ta karakterizojë, kur mendon se ai duhet të edukohet. Në qendër është nxënësi, pikënisja është nxënësi dhe qëllimi final është përsëri nxënësi, ai bëhet aktiv në këtë proces. Do të ishte një mësim dhe edukim i varfër në se mësuesi do të merrej vetëm me transmetimin e dijeve informative dhe të lërë mën-

janë pyetjen e madhe rreth të vërtetës, të asaj të vërtete që mund të jetë udhëheqje në jetë. Në çdo lloj profesioni është e rëndësishme që të bësh pyetje reflektive, por është po aq e rëndësishme edhe në një sipërmarrje morale. Ajo s'është thjeshtë një set aftësish teknike për t'u përcjellë nxënësve njohuritë. Mësimdhënia përfshin profesionalizmin dhe kujdesin e pandërprerë të nxënësve dhe të qenit i përgjegjshëm për zhvillimin e tyre në një shoqëri komplekse demokratike. Me fjalë të tjera, mësuesit duhet të mendojnë jo vetëm për “mjetet” që përdorin në procesin mësimor, por edhe për qëllimin e mësimdhënies. Kjo në vetvete rrit obligimet e mësuesve të përfshirë në këtë proces, veçanërisht të atyre mësuesve që japin mësim në shkollat publike, ku nxënësit janë të detyruar të ndjekin mësimin. Njerëzit në një shoqëri demokratike kanë të drejtë të besojnë se shkollat udhëhiqen nga disa parime themelore, si drejtësia, paanshmëria e trajtimit, ndershmëria, liria, barazia në shpërndarjen e burimeve dhe respektimi i diferencave. Si mësues dhe edukatorë marrim çdo ditë vendime. Dhe këto vendime mbartin ngarkesa të mëdha morale e psikologjike për nxënësit tanë. Si e ndajmë në kohën dhe vëmendjen midis nxënësve në klasë? Cilin mbështesim apo injorojmë, inkurajojmë apo dekurajojmë në bashkëveprimin tonë në klasë? Cilat njohuri zgjidhim për të theksuar apo anashkaluar? Secila nga këto pyetje përbën një çështje në vetvete dhe është në besimin dhe përkushtimin e mësuesve. Ka ardhur përfundimisht koha t'i largohemi tradicionalizmit në mësimdhënie e të bazimit mbi hamendësime të drejtuesve për mësimdhënien e mësuesve. Procesi ynë demokratizues tashmë sfidon disa nga hamendjet dhe konkluzionet e drejtuesve të shkollave për mësimdhënien e mirë të disa mësuesve. Njësi matëse themelore e një mësuesi të mirë është sigurisht përparimi akademik i fëmijëve e jo në se ata pëlqehen apo jo. Nuk është qëllimi të gjykosim mësuesit, por të hapësh biseda të shumëllojshme me ta në gjetjen e rrugëve më të mira të mësuarit në klasë. Prandaj çdo ndihmë e kontroll kërkohet të ngjallë një bashkëbisedim reflektues, ku drejtuesi të flasë e të diskutojë për ato që ka parë e dëgjuar në orët e mësimit. Me informacionin e duhur dhe me reagimet e vlefshme drejtori është në gjëndje të përmirësojë veprimtarinë ditore të punës së tij mësimore. Mënyra se si i vlerëson mësuesi nxënësit, si vlerësohen ata me notë etj., tregon profesionalizmin dhe ndjenjën e lartë të përgjegjësisë që mban dhe që shfaqet dukshëm, në se është i suksesshëm në arritjen e treguesve dhe në përgaditjen e nxënësve. Në fund të fundit, detyra e drejtuesit është t'u shërbejë mësuesve në fushën e kërkimit shkencor, që këta të fundit t'u shërbejnë fëmijëve. Mësuesi është njeriu që ka për detyrë të ndihmojë

të tjerët të mësojnë, të sillen në një mënyrë të re dhe të ndryshme nga më parë. Disa dhjetëvjeçarë më parë, mësuesit nuk kishin ndonjë përgaditje të madhe arsimore, por ishte pasioni e përkushtimi i tyre për t'u dhënë maksimalisht dije e kulturë brezave. Sot mësuesit janë shumë më tepër të arsimuar, trajtohen më mirë dhe respektohen më shumë nga shteti e shoqëria në krahasim me homologët e tyre të mëparshëm. Shoqëria shqiptare kërkon që mësuesit e saj të kenë arsim universitar dhe një përgaditje të veçantë si mësimdhënës. Kjo rritje në nivelin arsimor të mësuesve bazohet në lehtësimin e formimit shoqëror vetjak, intelektual të nxënësve të tij. Ka ardhur koha për mësues të suksesshëm që të jenë në gjëndje të realizojnë qëllimet dhe objektivat e programit, që vërtetojnë aftësitë e tyre për të realizuar rezultatet e planifikuara. Mbi të gjitha tashmë është bërë imperative më shumë se kurrë nevoja e kuptimit të thellë të vlerës që ka “integriteti personal” i mësuesit, që në thelb duhet të përputhet me kuintesencën e tij dhe të figurës si edukator. Besojmë se është moment që në punën mësimore, pedagogjike dhe edukative në shkollë të kemi një koncept modern për “suksesin”. Në jetën tonë të përditshme ne shpesh përdorim termin “mësues i suksesshëm”.

Dhe një mësues i tillë e merr këtë emërtim kur është në gjëndje të realizojë me sukses qëllimet dhe objektivat e programit dhe mbi të gjitha aftësinë e tij për të realizuar rezultatet që i ka planifikuar vetes. Një mësues me autoritet e profesionalizëm e shoqëron gjithnjë përkushtimi për nxënësit, të qenët i përgjegjshëm për profesionin, i drejtë, i kuptueshëm në shpjegim, i matur dhe mbi të gjitha me besim në vetvete. Ka mësues që u mungon autoriteti e profesionalizmi, i shoqërojnë gjithnjë rezultatet e dobëta, shprehin ashpërsi, paraqiten të ngurtë dhe të mërzitshëm me nxënësit, janë të shpërndarë e të pasigurtë, shprehin veprime inatçore dhe gabime shkencore në orët e mësimit. Ka mësues që nuk e kanë zgjidhur mirë destinacionin e tyre profesional, edhe pse punojnë e lodhen, nuk kanë efektivitet në punë. Sidomos shqetësues është fakti që jo rrallë ndeshim akoma mësues me koncepte të vjetra për mësimin dhe edukimin, e cila shfaqet në treguesit sintetikë të autoritetit profesional dhe në sistemin e dobët të komunikimit me nxënësin, duke mos i kuptuar si duhet “dimensionet” e reja të tij. *Kopententët duhet të mendojnë se çdo bëhet me këtë kategori mësuesish fiktivë.* Me fjalë të tjera, duhen forcuar lidhjet midis mësuesve jo në kuptimin pasiv dhe mekanik, por si një lidhje e brendshme, frymëzuar nga profesioni si qëllim dhe mision themelor i njeriut modern, në mënyrë që të zhvillohet kultura e solidaritetit profesional midis më-

ORGANIZOHET CEREMONIA PËRKUJTIMORE E DËSHMORIT TË ATDHEUT DEDË GJON UJKA I VUKSANLEKAJVE

Ditën e mërkurë më 20 gusht 2025, në varrezat e Vuksanlekajve të Hotit, në Tuz të Malësisë së Madhe, u organizua ceremonia përkujtimore e kryetrimin Dedë Gjon Ujka "Dëshmor i Atdheut", prijës, humanist dhe udhëheqës i flaktë i Kryengritjes së Malësisë së Madhe. Në këtë veprimtari përkujtimor të organizuar nga famullia e Tuzit në bashkëpunim me familjen e Gjeto Kol Ucit Camaj, morën pjesë klerikë të kishës françeskane, studiues, aktivist dhe përfaqësues të institucioneve vendore në Malësi e në diasporë.


Në nder të këtij kryetrimi u mbledhën edhe shumë malësorë, të cilët ruanin të freskët në kujtesën e tyre gojëdhëna të pleqve të Malësisë, lidhur me historinë dhe kontributin e Dedë Gjon Ujkës. Gjatë kësaj ceremonie krejt të veçantë u mbajtën disa fjalime nga klerikë, familjarë e studiues në përkujtim të këtij kryetrimi, si dhe u zbulua dhe u bekua varri memorial, i financuar nga familja e Gjeto Kolë Ucit Camaj.

Dedë Gjon Ujka ishte organizator dhe komandant i betejës së përgjakshme antiosmane në Qafën e Uglës, ku dha jetën për liri dhe atdhe, më 25 qershor 1911. Me vendimin nr. 792/19, datë 15.8.2020, qe-

veria shqiptare e shpalli Dedë Gjon Ujkën "Dëshmorë të Atdheut".

Dedë Gjon Ujka lindi rreth viteve 60 të shekullit të 19-të në Traboin të Hotit, në një kohë kur kryengritja e malësorëve

po kthehej gjithnjë e më shumë në një shqetësim serioz për Perandorinë Osmane si dhe pushtetin vendor otoman. Të rriturit nën hijen e Madhe të Kullës së Vuksan Lekës, e përmendur prej kohësh



suesve të suksesshëm dhe atyre me rezultate të dobëta. Natyrisht kjo i takon drejtorit të shkollës që ta ndërtojë dhe kombinojë punën bazuar mbi një koncept modern, në një platformë më të gjerë sociale e profesionale. Dihet tashmë se personaliteti i mësuesit të sotëm është më koherent dhe i integruar si i besueshëm për mendimet dhe ndjenjat që shfaq në profesion. Me kalimin e viteve në mësuesi zvogëlohen konsideratat dhe mospërputhjet, bëhen më të thjeshta dhe në këtë mënyrë arrijnë përfundimisht in-

dividin e integruar. Kur një mësues s'ka autoritet, duhet të dalë në pah dhe të merren masa që të mos ketë raste të tilla të përsëritura në kolektiva mësuesish, pasi kjo ndikon në formimin e nivelit të sjelljes që presim nga nxënësit dhe tipin e mësimdhënies që dëshiron të vendosë mësuesi. Nëqoftëse ndodh ndryshe, mësuesi do të shkatërrojë autoritetin e tij dhe ushtrimin e kontrollit drejtues në marrëdhëniet me nxënësit. Duke folur për nivelin e ulte të arsimit dhe vleresimin e profesionit të mësuesit në vendin tonë, ja vlen të kujtojmë

thenien e vyer të poetit të degjuar Franc Kafka, simbolizon letersinë moderne. Ai lidhur me vleresimin e arsimit ka thënë: "Ne do të shkatërrosh një komb shkatërojnë atij arsimit." Sigurisht barra kryesore e përgjegjësisë për nivelin dhe pozitën ku ka rënë figura dhe profesioni i mësuesit sot bie mbi shtetetin dhe instancat eprorë të arsimit. Ndaj roli i mësuesit të sotëm është të drejttojë dhe kuptojë mendimin e të dëgjojë me kujdes idetë e nxënësve. Duke vepruar kështu, nxënësit bëhen mësues dhe klasa bëhet një komunitet i fuq-

për trimni e dinjitet malësor, bani që këto vlera të brumosen edhe në karakterin e tij prej patrioti të flaktë, virtyte këto që do t'i gjenerojë në veprime e kontribute si një Rilindas i Flaktë për çështjen kombëtare e atdhetare shqiptare. Dedë Gjon Ujka përmendet si një humanist e patriot i rrallë, që shiti shumë nga pronat e veta për të la borxhet e Hotjanëve, në ditët më të vështira të spastrimit etnik, të ndërmarra nga ushtria turke në Hot pas Lidhjes së Prizrenit.

Dedë Gjon Ujka ishte nismëtar dhe firmëtar i vendimeve të kuvendeve të Malësisë për faljen e gjaqeve, mobilizimin e luftëtarëve, paisjen me armatim dhe frymë qëndrestare, patriotike e gjithëpërfshirëse, të cilat i paraprinë të lavdishmes Besëlidhja e Malësisë, vendime fuqiplote, që morën za' edhe në qarqet diplomatike ndërkombëtare të asaj kohe.

Dedë Gjon Ujka ishte prijës dhe organizator i betejës më të përgjakshme të Kryengritjes së Malësisë në Qafë të Uglës, ku dhe bie dëshmor në vijën e parë të frontit.

Organizimi i kësaj ceremonie solemne në nder të këtij Rilindësi Malësor u vlerësua dhe gjeti mbështetjen e të gjithë opinionit publik, si një nevojë emergjente për rishikimin e historisë së Malësisë dhe rivlerësimin e figurave më të ndritura të saj.

Nder e Lavdi DËSHMORIT TË ATDHEUT Dedë Gjon Ujka! Mirënjohje e respekt bijve të Gjeto Kolë Ucit CAMAJ, për këtë përndritje të jetës dhe veprës së këtij Kryetrimi Malësor!

Rita Shkurtaç, Gusht 2025



ishëm i të nxënësit. Kur secili respektohet si një koleg intelektual, "tarafet" kalojnë në sfond dhe gradualisht shuhet, doemos vjen debati që përqëndrohet te idetë. Studimet e sotme tregojnë se mësuesit e suksesshëm janë të drejtë, të përgjegjshëm të kuptueshëm, të dashur, nxitës, originalë, tërheqës, të ekuilibruar, të matur dhe me besim në vetvete dhe me aftësi për të drejtuar saktë procesin e diagnostikimit pedagogjik të nxënësve. Më këto risi bëhet e mundur që nxënësit të jenë perceptues dhe marrës të mirë të emocioneve që transmeton mësuesi dhe shpesh ato kanë kurajon të reagojnë ndaj tyre. Një mësues që është entuziast për lëndën, që e tregon edhe përmes shprehjeve të fytyrës, ka më shumë të ngjarë të mbajë të përqëndruar vëmendjen e nxënësve, se sa një që nuk i ka këto cilësi. Fukuyoma ka thënë me të drejtë se "Qëllimi i vetëshpallur i arsimit modern është t'i lirojë njerëzit nga paragjykimet dhe format tradicionale të autoritetit". Ndaj, në drejtim të shkollave duhet të përzgjedhim më të zotët e më të aftët në mësuesi dhe jo me ata mësues e drejtues shkollash, që arsimin e shohin si vend punësimi. Sepse sikurse duket edhe në "epokën dixhitale", roli i shkollës dhe puna e mësuesit janë të pazëvendësueshme. Ata kanë në dorë "armët e duhura" për të ndihmuar nxënësit të hapin udhët e dijes dhe mënjurisë. Në se duam që shkollës t'i japim përfundimisht vendin që meriton, në se duam që ajo të qëndrojë në "themele të qëndrueshme", do të ishte udhës që të gërshejtojmë më mirë mësimin pedagogjik me atë social-edukativ. Janë të gjitha mundësitë që mësuesit dhe drejtuesit të plotësojnë këtë imperativ të shkollës sonë moderne.

PËR NJERIUN

“Njeriu është masa e çdo gjëje”, thoshte me të drejtë Protagora. Në mos qoftë krijuesi i çdo gjëje, ai është i vetmi mbi këtë Tokë, i cili ju jep ekzistencë gjërave tjera. Pa njeriun esenca nuk do të kishte asnjë kuptim. Është Njeriu ai që i jep ekzistencë atyre. Njeriu është ai, që vështron, mendon dhe interpreton realitetin e jashtëm. Ai është, përmes kapaciteteve subjektive të tij, krijuesi i perspektivave të realitetit. Andaj edhe është cilësuar si masa e çdo gjëje.

Kur e themi këtë, nuk duhet të harrojmë se këtu e kishim fjalën për Njeriun si tërësi, si nocion të pandashëm, si qenie universale e njësuar në kohë e hapësirë. Pra, për Njeriun si një mendje e frymë tek i cili gjejmë përmbledhjen e të gjithë njerëzve si trupa të veçantë fizik dhe si mendje të veçanta njerëzore. Sepse, nëse Njeriu është në mënyrë absolute masa e çdo gjëje, njeriu si qenie e shumëfishë, me subjektivitetin e tij të veçantë, nuk është më masa e çdo gjëje, por vetëm një garues përbrenda llojit, i cili është i thirrur të kontribuoj në përcaktimin e përmasës së gjërave të kësaj toke.

Dhe kur themi “garues”, kemi në mendje mos pajtueshmërinë e natyrshme dhe historike të njerëzve në lidhje me interpretimin e realitetit. Mos pajtueshmëri, e cila është shpërfaqur mjaft mirë, në formë alegorike, në besimet e lashta mitologjike dhe, po ashtu, edhe në fetë e mëvonshme monoteiste. Ndërtimi i kullës së Babelit prej ku Zoti bëri që njerëzit të mos flasin më të njëjtën gjuhë. Kurse vëllavrasja ndërmjet dy djemve të Adami-t dhe Evës, Kainit dhe Abelit, e shpërfaq natyrën konfliktuale të njeriut apo mos pajtueshmërinë e përhershme me fatin e tij. Po të njëjtën gjë e shpërfaq edhe mitologjia e lashtë, kur e ndanë Zotin e qiellit (Olimpit), Zeusin, dhe vëllain e tij, Zoti i nëntokës, Hadesin. Tek Taoizmi, po ashtu, Jin-gu dhe Jang-u, të pasqyruara me ngjyrën e zezë dhe të bardhë, përfaqësojnë njeri energjinë pozitive, kurse tjetri energjinë negative. E gjithë kjo të krijon përshtypjen se “e mira” dhe “e keqja” janë si dy vëllezër të papajtueshëm me njëri-tjetrin.

Pra, të gjitha këto histori e tregime na ofrojnë në të njëjtën kohë edhe Njeriun e njësuar, qoftë në formën e alegorisë së prindërve të përbashkët qoftë nga zanafilla e një gjuhe, por edhe njeriun e shumëfishuar, të pa pajtuar, të dyzuar në mes të mirës dhe të keqes, i rishpërndarë në shumë gjuhë, kultura, ngjyra, etni e në shumë ndjenja të veçanta. Pra, në thelbin e këtyre alegorive, gjejmë edhe Njeriun si njëjës edhe njeriun si shumë.

E gjithë kjo na shtynë ta mendojmë njeriun edhe në veçorinë e tij, por edhe në esencën e tij si tërësi. Gjë që bëhet e vështirë për ta menduar në këto dy dimension kur jemi përballë realitetit njerëzor; sidomos kur jemi në papajtueshmëri apo momente konflikti. Atëherë, Njeriu abstrakt shpejt zhduket përballë njeriu-t të përbërë prej mishi e ashti; të ngërthyer nga interesa e ndjenja të veçanta; i rrënjësuar në një gjuhë

të veçantë; i zhytur në një kulturë tjetër; i bërë në një racë e ngjyrë tjetër, në sytë e tanë, ai humbet esencën e tij njerëzore. Ai që do të duhej të na ngajë siç në formën abstrakte, bëhet kaq i ndryshëm në realitet; kaq i huaj. Dhe, të kërkosh Njeriun tek çdo njeri i veçantë, cili do qoftë ai, duket sikur është abuzuar me kornizën; sikur i kemi dhënë shumë lartësi nocionit Njeri krahasuar me dimensionin krejtësisht të vogël të njeriut.

Ky dimension abstrakt i Njeriut, sa herë që nuk është gjetur në formën e realitetit njerëzor, është bërë edhe justifikimi kryesor për tu futur në konflikt me njëri-tjetrin. Prej se ekzistojnë bashkësitë njerëzore e deri sot në qytetërimet moderne, konflikti ndër njerëzor nuk ka të ndalur. Dhe do të ishte naivitet të mendohet se një ditë do të marrë, përfundimisht, fund. Mirëpo, nëse konflikti ndër njerëzor ka ekzistuar dhe do të ekzistoj, dhe ne nuk kemi mundësinë ti japim fund atij ndonjëherë, kjo nuk do të thotë se këtë konflikt të përhershëm, pavarësisht formave të tij të veçanta, nuk duhet ta menaxhojmë si qenie njerëzore. Kjo, pra, duke i dhënë rregulla përtej palëve; duke i dhënë baraspeshë forcave apo duke u thirrur në një Drejtësi që tejkalon interesat elementare të palëve në konflikt.

Në fakt, këtë është munduar ta bëjnë shoqëritë njerëzore prej kur ekzistojnë. Ndjenja e pasigurisë; nevoja e rregullave; nevoja e organizimit; nevoja e një drejtësie të institucionalizuar, e ka shtyrë atë që të bashkohet me të tjerët për të krijuar bashkësi njerëzore. Natyrisht, se ai është bashkuar së pari me ata tek të cilët ka gjetur më së shumti ngjashmëri (gjaku, gjuhe, kulture e të tjera). Kjo, pra, për të siguruar jetën, pasurinë dhe trashëgiminë prej të gjithë atyre tek të cilët ka ndërë më pak ngjashmëri dhe, për pasojë, më pak besim. Kështu janë krijuar bashkësitë, mbretëritë, qytetet-shtete, perandoritë dhe kombet, me qëllim zhvillimin e një ekzistence më të sigurtë me njëri-tjetrin. Mirëpo, në të njëjtën kohë, duhet ta dimë se po ato janë zhdukur kur kuptimi i parë i saj, ekzistenca më e sigurtë njerëzore, është humbur apo zëvendësuar me mohimin dhe asgjësimin njerëzor. Gjë që shqiptarët e kanë mirënjohur prej pushtimeve dhe luftërave të njëpasnjëshme nëpër histori.

Dhe mohimi i njerëzisë së tjetrit nuk ka ndodhur rrallë në histori, përkitazi, as në historinë e popullit shqiptar. Organizimi shtetëror ka gjithmonë në thelb monopolizimin e forcës dhe ushtrimin legjitim të saj. Dhe, jo rrallë herë, “legjitimiteti i ushtrimit të forcës” merre kahe krejtësisht anti-njerëzore siç ishte rasti me nazizmin në Gjermanin hitleriane. Apo, siç ishte “legjitimuar” përdorimi i forcës ndajë popullsisë shqiptare të Kosovës nga Serbia millosheviçiane. Një regjim anti-njerëzor gjithmonë fillon duke u angazhuar në një diskurs në të cilin mohohet njerëzia e tjetrit dhe shkon deri aty sa t’ju mohohet edhe e drejta thelbësore për të ekzistuar.

Prandaj edhe ata që kanë qenë bartës të

një filozofie humaniste janë angazhuar që e drejta njerëzore të bëhet normë mbi çdo normë tjetër dhe, po qe nevoja, të mbrohet me një mbi-fuqi në krahasim me të gjitha fuqitë anti-njerëzore ekzistuese. Kjo bëri që të krijohen ka hera një seri e të drejtave njerëzore. Në fillim u bë në kuadër të shteteve dhe, më vonë, këto koncepte u zgjeruan në një kuadër ndërkombëtar. Si shembull të parë kemi miratimin, qysh më 1689, në Angli të Bill of Right. Pastaj, Deklaratën e të Drejtave Njerëzore më 12 qershor 1776 në Virgjini të SHBA-së; Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe e Qytetari më 3 nëntor 1789, në Francë. Më vonë, pas krimeve të nazi-fashizmit, bota e lirë duhej të bënte diçka për parandalimin e ardhshëm të krimeve kundër njerëzimit. Kuadri shtetëror nuk mjaftonte më dhe të drejtat njerëzore duhet të kishin një mbrojtje dhe aplikim më universal. Me këtë synim ishte krijuar Organizata e Kombeve të Bashkuara më 24 tetor 1945. Qëllim ishte ruajtja e baraspeshës në mes shteteve dhe vënia në pah e të drejtave njerëzore. Kjo bëri që, qysh me 10 dhjetor 1948, OKB-ja të miratoi Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut. Vetëm dy vjet më vonë, më 4 nëntor 1950, u miratua nga Këshilli i Evropës edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Atë, që duhet të dimë është se të gjitha këto deklarata e konventa për të drejtat e njeriut janë ndikuar e shtyrë nga një filozofia humaniste, e cila i ka paraprirë botës Perëndimore qysh nga koha e Sokratit e deri më sot. Filozofi, e cila i lë interpretimin e botës njeriut dhe kapacitetit të tij për ta menduar në mënyrë racionale atë, pra, pa një ndërlidhje me interpretimet mitologjike, tradicionale apo religjioze. Kjo e shtynë njeriun që të mos e mendoj më veten si një element ndër të tjerë të një krijimi të jashtëm, fati i të cilit është krejtësisht i parashkruar nga fuqi të mbinatyrshme. Përkundrazi, filozofia humaniste mendon se njeriu mund ta zotëroj fatin e tij përderisa ligjet e natyrës e lejojnë atë. E bazuar mbi vullnetin dhe kapacitetin për të menduar, filozofia humaniste e sheh njeriun, dhe shoqëritë njerëzore, prej perspektivës përparimtare. Ajo beson në kapacitet njerëzor për një zhvillim dhe ndryshim të vazhdueshëm të mirëqenies së përgjithshme.

Nga shekulli XIII, kjo filozofi merre formën e një lëvizje intelektuale, artistike e letrare në Itali ku, me Petrarkun, rimarin jetë idetë humaniste dhe përkthehen në një sistem edukimi të veçantë përmes hapjes së shkollave të saja. Më vonë, iluministët i japin ideve humaniste misionin intelektual për ta çliruar njeriun nga obskurantizmit, skllavëria dhe çdo forme tjetër e shtypjes njerëzore. Madje, August Konti (1798-1857) shkon aq larg sa kërkon të krijoj një “fe humaniste”. Ndërsa filozofët utilitarist anglez, Jeremy Bentham e John Stuart Mill, e rifokusojnë atë tek lumturia njerëzore, duke i dhënë qëllim zhdukjen e vuajtjeve dhe dhimbjeve përmes mjeteve të natyrshme. Dhe sot, e gjithë filozofia humaniste qëndron në të njëjtën esencë ku njeriu konsiderohet si e vetmja qenie racionale, e vetëdijshme, thellësisht e ndjeshme dhe me kapacitetin për të reflektuar mbi vetën dhe mbi botën. Pra, si të vetmen qenie që ndjen padrejtësinë. E vetmja qenie që ka kapacitetin

për të çuar përpara zhvillimin në mënyrë të suksesshëm në fusha të ndryshme nga të cilat rezulton edhe përmirësimi i mirëqenies së tij. Kjo sugjeron se, atij i takon një jetë e ndershme, e mirëqenë dhe e lirë (jo e varur) mbi këtë tokë. Në këtë mënyrë, njeriu konsiderohet vetë-aktori dhe vetë-interpretuesi i veprimeve të tij dhe jo si një krijesë e nxitur nga fuqi mbinatyrrore. Si i tillë, ai duhet të edukohet dhe të zhvillohet në një kulturë ku njerëzia është një empati e gjithëhershme për njeriun, ku çdo marrëdhënie shoqërore duhet të qëndrojë në respektin ekzistencës së tjetrit dhe të drejtave të tij.

Njeriu është enigma ime e përjetshme

Ky përshkrim i shkurtër për lexuesin e bënë ta kuptoj se cili është pozicioni im filozofik mbi njeriun. Besoj se u vetëkuptua, se i përkas frymës dhe shkollës humaniste. Megjithatë, përgjatë përshkrimit, e kuptova se sa e vështirë qenka të shkruash për njeriun. Sa qenie e ndërlikuar mbetet për tu trajtuar në pak rreshta Ai. Dhe kjo, edhe për një si mua që gjithë jetën isha me njeriun dhe për njeriun. Isha me të në halle dhe vuajtjet e tij. Isha gjithmonë me të kur kërkonte liri dhe, po me të isha, kur kërkonte nderin e mirëqenien e tij. Isha përkrah tij në çdo proces shoqëror dhe e pashë në të njëjtën kohë sa madhështinë e sa brishtësinë e tij. E pashë se sa i përsosur mund të ishte, por edhe sa shumë defekte mund të kishte. E njoha në dashuri, e njoha në urrejtje; e njoha në sakrificë; e njoha në përlulje; e njoha në gëzime e buzëqeshje; e njoha në mërzë e lot; e njoha në lumturi; e njoha në dhimbje; e njoha në pasuri dhe e njoha në varfëri. E njoha në ndjenjat më të thella të tij; e njoha edhe në unin më mizor të tij. E njoha në të gjitha format e filozofisë, në të gjitha kulturat, në të gjitha racat, ngjyrat, e gjuhët. Dhe, pas gjithë asaj që lexova dhe përjetova prapë pyes: Cili është vërtetë Njeriu?

Nuk e di. Do të thosha se është enigma ime e përhershme. Preokupimi im i parë dhe i fundit. Me të dhe për të jam angazhuar në politikë. Ky është motivi im më i thellë në çdo angazhim, në çdo ndërmarrje që kam pasur dhe që do të kem. Tek njeriu besoj, pavarësisht defekteve të tij. Besa, për arsye të pozitës time, më shumë kam frikë se do ta tradhtoj unë se, sa do të më tradhtoj ai. Pritshmërie e çdo votuesi, që të mos harroj dhe të mbroj vlerat mbi të cilat jam angazhuar është e drejtë. Pra, të mos harroj vlerën e parë: Njeriun. Dhe, e di se vetëm në besnikëri të kësaj vlere politika mund të ketë gjithmonë kuptim. Njeriu, është për nga esenca qenie politike dhe e vetmja për sa njohim deri më sot. Nëse angazhimi politik nuk nis prej tij dhe nuk qëndron për të, atëherë, ai nuk mund të quhet më “angazhim politik”.

Megjithatë, duke e thënë kështu, për lexuesin e panjohur kjo mund të tingëllojë si një filozofi naive, me ngjyrim kozmopoliten, ku krijohet përshtypja se angazhimi im është i pa përkufizuar, në kohë e hapësirë. Të duket si një përqafim naiv i njeriut si tërësi ideale, brenda të cilës është rrafshuar shumë herë realiteti i zymtë i shoqërive njerëzore, me konfliktet e luftërat e shkaktuara nga interesat e ngushta dhe egocentrike të tyre. Apo kemi harruar se larg këtij

Dode Kaçaj – Zëri që nuk u shua kurrë

Në historinë e Malësisë së Madhe, ka njerëz që nuk maten vetëm me vitet që jetuan, por me gjurmët që lanë. Ndër ta, Dode Kaçaj qëndron si një nga figurat më të shquara e më të dashura – poet i frymëzuar, mësues shembullor, intelektual i formuar dhe njeri i pastër si uji i krojeve të bjeshkës.

Shtatlartë, dymetrosh si lisat e maleve ku lindi e u rrit, ai mbartte forcën e natyrës dhe butësinë e një zemre të madhe. Balli i gjerë, shikimi i kthjellët dhe buzëqeshja e tij e matur e bënë të dukej njëkohësisht burrë autoriteti dhe mik i afërt. Në çdo shoqëri sillte urtësi, kulturë dhe ngrohtësi njerëzore.

Dode Kaçaj ishte jashtëzakonisht popullor. Shkeli pothuaj çdo vatër të Shoshit e të Malësisë së Madhe, duke biseduar e bashkëbiseduar me burra, gra, pleq, plaka dhe të rinj. Fliste lirshëm me të gjithë, sikur të ishte moshatar me plis-bardhët e odave të vjetra. Në këto takime, binomi historik Gjon Marashi – Balë Mark Milani ishte një nga thesaret më të çmuara që e frymëzoi. Nga bisedat e tyre lindën disa nga perlat epike të tij, kushtuar Luftës kundër Turgut Pashës, betejave me Malin e Zi dhe eposit heroik të Pal Gjakës, Marash Tucit, Sokol Tonës, Zeke Jakinit e të tjerëve.

Ishte pjesë e një fisi artistësh, gjak i njëjtë me tenorin e madh Lukë Kaçaj. Por jeta nuk ia kurseu pengesat. Në rininë e hershme, u përball me padrejtësi biografike, të cilat nuk e thyen. Përkundrazi, e bënë më të qëndrueshëm, më të vendosur të mbetej vetvetja.

Në detyrën fisnike të mësuesit, ishte

shembullor. Ishte njeri i drejtë dhe me integritet të palëkundur. Në fillimet e demokracisë, u bë një nga opozitarët e parë të vendit, deputet i Parlamentit të parë pluralist. Pa dyshim nga zërat më cilë-



sore të deputetëve veriore. Ai nuk ndoqi verbërisht asnjë lider, nuk pranoi të bëhej vegël e pushtetit. Politika nuk arriti ta njolloshte – mbeti i pastër, i kthjellët dhe i papërkulur.

U diplomua në Fakultetin e Letërsisë dhe u bë një nga zërat më autentikë të poezisë malësore bashkëkohore. Vargjet e tij nuk ishin të largëta e të huaja për

njerëzit – ato ishin këngë të zemrës, të lindura nga dheu i Vajzës e nga fryma e maleve, të destinuar për t'u kënduar e recituar ndër mote. Ishte një nga promotorët e mëdhenj të folklorit, drejtues artistik në festivale lokale dhe në ansamble të njohura, duke u ngjitur deri në skenën e Gjirokastrës krahas artistëve si Sali Mani, Mehili Çuni, Violeta Deda, Kole Buçi, Kolë Gjon Çezma, Pretash Nilaj, Jonuz Delaj, grupi burrave të Malësisë dhe ansambli Shoshi.

Mbi 13 vite punoi si jetoi në Palaj të Shoshit, ku shkroi tekste këngësh, që i dhanë zë historisë kësaj zone, e cila ju be vendlindja e dytë dhe frymë brezave të rinj. Ishte mik i gjyshit tim, Balë Mark Milani, mik i shtëpisë sonë dhe mik i gjithë Shoshit. Malet e Shoshit e qanin si të birin e tyre, sepse në vargjet e tij gjenin veten dhe shpirtin e tyre krenar. Cikli poetik "Kangë maja krahut" mbetet si një simfoni e malësorit – këndohet me mall e recitohet me dashuri, si një flamar poetik që nuk bie kurrë.

Dode Kaçaj nuk ishte vetëm trup i fortë dhe shtat i madh – ai ishte mendje e ndritur, shpirt i bardhë dhe zemër e gjerë. Në trup ishte si mali, në fjalë si bilbili, në shpirt si burimi i pastër, që ushqen një krahinë të tërë. Edhe pse sot nuk ecën më mes nesh, fjala dhe kënga e tij vazhdojnë të frymëzojnë, duke dëshmuar se disa njerëz nuk vdesin kurrë – sepse kur zemra e tyre pushon, zëri i tyre jeton.

PRELE MILANI

Shllaku

1941

*"Lufton Shllaku e Dushmani,
Lufton Gushta e Temali,
Na u ka pri Kolë Bibë Miraka,
Ushtrin serbe e mbloi flaka,
E mbloi flaka e u dorzue,
Por Kol Biba asht varrue!"*
*"T'plaçin sytë, mori Serbi!
Ku je nis ti kshtu me hi?!
/Ku je nis kshtu me shkue?!..
Gurit t'Kuq e Gurit t' Bardh!
Krisi n' Prekal pushka e parë!*
*Kundër Shkaut Mertur e Shalë!
Po luftojnë trimat përball
Po vjen Shkodra tuj u afrue.
Thonë:- Kol Biba ish kan varrue!
Ish kan trim ai, ish kan djal!
Ma kreshnik Zoti s' e fal!
Si ato burrat si janë kan motit,
N' ato kohë të Kastriotit.
burr si veten kish pas vllan,
Me Berish dhe me Thaçnjan!
Kurkund vend (Serbit) s' i lan me xan.*

(Nd. Ndoja, DUSHMAN-TEMAL, Shkodër 2008, f.107-109).

Kol Biba tregon::I gjymtuem -se n' at kohë, ende nuk mund të qëndrojshe me ecë me kambët e mija nga plumbat, që më kishin shpartallue kërcinin e kambës në mbrojtjen e Shkodrës, kundër ushtrisë jugosllave në Koman 13 prill '41,-ktheva ne Iballë për me pushue.

*Paraqiti për botim Shkelzen Mulaj,
Marre nga Ben Oroshi*

ideali "Njeri", ekziston pabarazia ndërmjet njerëzve, lufta për sundim, shkatërrimi i mjedisit, dhuna e vrasjet, urrejtja, shtypja e shfrytëzimi nga njeriu mbi njeriun. Pra, në një realitet ku mbizotëron një sundimi i njeriut mbi njeriun. Pra, çka e kishte shtyrë Hobsin të thoshte se njeriu është ujë për njeriu-n?!

Jo, nuk jemi as naiv as të përhumur në kohë e hapësirë. Besa i përkasim plotësisht frymës dhe shkollës "realiste" për të cilën do të flasim në shkrime tjera. Siç e kemi thënë edhe më lart, jemi të vetëdijshëm se njeriu është i dyzuar ndërmjet të mirës dhe të keqes. Por filozofia jonë ka zgjedhur gjithmonë ti besoj anës tij të mirë, pa ja mohuar anën tjetër. Ne nisemi nga postulati se njeriu duhet të jetë njeri për njeriun dhe ai duhet të jetë i tillë në çdo rrethanë. Pra, ne e pranojmë njeriun siç është me të mira dhe me të këqija. Angazhimi ynë konsiston në përforcimin e anës së tij të mirë. Kurse ata që mund të na mendojnë si kozmopoliten klasik, duhet ta kuptojnë më mirë se cilit pozicion i përkasim në raport me botën.

Qytetar i botës; shqiptar i Shqipërisë

"Jam qytetar i botës" i ishte përgjigjur Diogjen Ciniku Aleksandërit të Madh, kur e kishte pyetur se nga cili qytet ishte. Më vonë, kjo thënie kishte ndikuar tek filozofët stoik, veçmas tek Epikteti dhe Marc Aureli. Atë që harrojmë shpesh

është të kujtojmë se cili në të vërtetë ishte autori i kësaj shprehje. Harrojmë ta kujtojmë se Diogjeni ishte një njeri i pa strehë. Ndoshta për këtë arsye edhe u quajt Diogjen Qeni. Ndërsa, Epikteti kishte lindur dhe ishte rritur si skllav (rob). Pra, asnjëri, në të vërtetë nuk ishin qytetar të ndonjë vendi të caktuar. Andaj, edhe filozofia e tyre ishte e lidhur drejtpërdrejt me gjendjen apo statusin e tyre shoqëror. Dhe kur kjo filozofi vjen nga një status tjetër shoqëror, nga pozita e lart, siç ishte ajo e perandorit romak Mark Aureli, ajo merre krejt tjetër kuptim. Me këtë rast, shprehja "qytetar i botës" nuk do të thotë më të mos jesh i asnjë vendi., e cila mund të përkthehet edhe të mos jesh pjesë e asnjë historie. Përkundrazi, tek Mark Aureli merre kuptimin të jesh në këtë botë. Ta njohësh botën; të jesh në një raport thelbësor me të, duke e pranuar pjesën e përgjegjësive që ke ndajë saj. Çka nuk e përjashton të jesh i një vendi specifik; i një identiteti të caktuar; i një gjuhe e kulture; i një shoqërie njerëzore apo një shteti e kombi të caktuar.

Në këtë rast, kur ne e përqafojmë njeriun si tërësi; kur ne ndihemi pjesë e kësaj bote si gjithësi; kur ne e njohim vlerën e çdo kulture tjetër; kur ne mësojmë gjuhë tjera; lexojmë e studiojmë, ndonjëherë edhe kërcëjmë e këndojmë; krijojmë marrëdhënie me njerëz të racave, ngjyrave, gjuhëve dhe kombeve tjera, kjo na bënë ta

kuptojmë dhe ta ndjejmë edhe më shumë njerëzinë dhe botën. Pra, të jemi në botë dhe në një raport thelbësor me të. Mirëpo, kjo nuk na bënë të zbehemi në veçorinë tonë. Njeriu si tërësi nuk kemi kuptuar asnjëherë si uniform, por si llojllojshmëri. Ata që e duan njeriun uniform, janë ata që konsiderojnë se veçoria e tyre duhet të marrë përmasat e universalitetit njerëzor. Ide e mendësi me të cilat udhëhiqen vetëm fashistët. Ide e mendësi e bazuar mbi urrejtjen e tjetrit dhe tendencë për ta shtypur e tjetërsuar atë.

Përkundrazi, filozofia jonë politike – e përkthyer në angazhim – është i bazuar mbi pranimin e tjetrit dhe të të huajës. Por kjo nuk nënkupton asnjëherë të heqim dorë nga qëndresa jonë për të qenë dhe për të mbetur në veçorinë tonë. Është atdasheduria, pavarësia dhe veçoria e gjuhës, por edhe zhvillimi i një kulture të veçantë, që na udhëheq. Jo urrejtja. Është ndjenja e të qenies shqiptar, qytetar i Shqipërisë, që na bënë të jemi banorë e miq të veçantë të botës tjetër. Pa këtë veçori, do të ishim të tretur e të humbur në botëkuptim. Do ta fitonim botën, por do ta humbnim kuptimin e saj. Dhe kur humbet kuptimi, humbet vetë njeriu.

Andaj, filozofia jonë politike çon në angazhim për veçorinë tonë shqiptare. Duke luftuar për veçorinë tonë, jemi, në fakt, duke luftuar edhe për njeriun si tërësi. Besa, sa më shumë e zhvillojmë vendin

tonë, e përmirësojmë mirëqenien tonë, e përforcojmë edukimin tonë, aq më shumë e fuqizojmë njerëzinë tonë. Pra, pranimin e të huajës apo e tjetrit. Në këtë kuptim, dhe vetëm, në këtë kuptim qëndrojmë në njerëzinë tonë dhe i kontribuojmë idealit Njeri.

Vlerat njerëzore në politikë

Për fund, këto rreshta e shprehin një tentativë të parë dhe të përgjithshme për ta përkufizuar vlerën e parë NJERI, me të cilën do të angazhohem në politikë. Ishte e domosdoshme, së pari, për t'ia thënë vetës me shkrim, si një introspeksion, i cili kërkon ti verifikon ndjenjat dhe motivet e tij të para të çdo angazhimi të më-tutjeshëm. Pastaj, qëllimi ishte edhe për ti vënë mbi tavolinë të hapur para çdo votuesi, i cili nëse ishte nisur për të më votuar nga një ndjenjë simpatie, të ketë një motiv më të arsyeshëm për të më përzgjedhur si deputetin e tij të ardhshëm.

Unë deputet, do të jem gjithmonë i lidhur për vlerat dhe parimet e mija. Ky lloj prezantimi publik është edhe një lloj i marrëveshjes me votuesit e mi cilët do qofshin ata. Çdo politikë e imja do ta ketë në qendër të vëmendjes njeriun si tërësi dhe shqiptarin si veçori. Pra, do të jemi gjithmonë si njeriu për njeriu-n në çdo reflektim, fjalim e akt politik.

LABINOT GJINI

Lec Shllaku, arkitekti i teatrit Profesionist Shkodrane dhe Elbasanas, në datëlindjen e 100-të

Lec Shllaku, sot do ishte rrumbullak 100 vjeç, që fort iu afrua, por nuk e gëzoi këtë datëlindje, që ëndërron çdo frymore me ndërgjegje. Ky kapak shekullare i fillim vjeshtës së tretë nuk e gjeti këtu. Ai vetëm fizikisht mungon mbasi në kujtesën tonë mbetet si bazile vetmitare. Trembëdhjetë mote kaluan që trup i Kolec (Lec) Shllakut pushon në hijen e selive nder Rremaj, në atë tokë të mbjellë me eshtrat e të shumëve të qytetit të shumë kënduar veriperëndimore.

Ka mbi trembëdhjetë vjet që ky burrë fisnik me pamje madhështore i mungon Piacës (shëtitorës) shkodrane, i mungon lozhave të Teatër "Migjeni", studios së punës librave dhe mbi të gjitha miqve dhe familjarëve.


Prej varrit, që ka për shtroje dheun e murrme, e mbuloje djerrin me trëndafila, na flet prej jetës së pasun, për herë në vegime arti. Kujtimet e Lec Shllakut janë jeta dhe historia e epokës artistike, që e polli, e rriti dhe e lartësoi. Një jetë plot batica e zbatica, dimra të acarte, pranvera të blerta, vera zhuritëse dhe vjeshta ku e blerta pak nga pak fillon të shndërrohet në të verdhe te arte dhe ne ngjyrë kafe te pjekur, ku pemët pak nga pak bjerin gjetet duke shtruar tapeta te artë të vdekjes së bekuam. Kujtimet e Lec Shllakut janë një mozaik veshur me mantelin fisnik të atdhetarit, xhamadanin e artë të mirësisë, gozhupin e galme të burrërisë arbërore dhe kostumin ma trendi te epokës post modern, që ja ka harrua emrin djepit të drunjtë të traditës që përkundi me ninulla dashurish të moçme. At' Luigji Palaj, atdhetar e martir i kishës; At' Gjon Shllaku filozof dhe mësues martir i ndërgjegjes kombëtare; At' Bernardin Palaj bleta e visareve kombëtare; At' Bernardin Shllaku arqipeshkv i Dioqezës së Pultit; shqipja martire e lirisë Marie Shllaku; Dom Mark Sllaku fatos i kishës; Avokat Paulin Pali, një nga emrat më të shkëlqyer te inteligjencës shkodrane i martirizuar nga diktatura komuniste së bashku me të vëllain poetin sentimental, Gasper Pali; Kapiteni i Madh i Kombëtares shqiptare Lin Shllaku, janë filizat e trungut të Gabet Kuçit, atlashit të Shllakut nën hijen e të cilëve blerohet dhe flladitet kultura shkodrane, e cila pa trashëgiminë gjenetike të këtij babëloku do të ishte si tenxherja pa kapak. Prelë Shllaku (fotokopje e "Kamani"), filiz i Logut të Gegajve mbi nga leni i mrizeve bjeshkatarë sa herë te rrahur nga era dhe ortiqet, po aq here përtërirë e gjallëruar në rrënjë e gjethe e harlisur në kurma e dege vigane.

Kolec (Lec) Prelë Shllaku (1921 - 2007). xhunjor i vëllezërve Gjon e Luigj aktor, regjisor, shkrimtare studiues, publicist, njeri me aksesore të gjerë kulturor, polyglot, njohës i disa gjuhëve të huaja, si greqisht, latinisht, italisht, rusisht, ser-

bokroatisht, frëngjisht dhe gjermanisht.

Lecit, në moshën 3 vjeçare i vdiq i ati së bashku me nënën e vet, Pinën, e me vëllezërit u rritën në familjen e dajës së vet, Ndoc Temali, rrobaqepës humorist, teatrist i shquar i skenës shkodrane e be-

23 vjeç dhe u dënua me burgim të përjetshëm (101 vjet) fillimisht si anëtar i grupit të "Bashkimit shqiptar", si përfundim bëri 12 vjet në burgun e Burrelit dhe në ballat e Myzeqesë. Në burg u njoh me Peshkop Visarion Xhuvani, me të cilin thelloi



jtari në zë parësor i Karnavaleve në qytetin e Shkodrës. Të varfër, por të bardhë si pëllumbat nder dajë aty shpërthyen e morën hov prirjet e Lecit dhe të Gjonit

Gjonin i mesmi dy vjet me vogël se Lecit (helenisti i shquar), filloren e kreu në kolegjin françeskan, ndërsa 7 vjeçarën në shkollën shtetërore tek "Dugajtë e reja". Nga 24 shtatori 1935 deri 9 dhjetor 1945 studioi në Seminarin Papnuer të Jezuitve, duke bërë edhe vitet e larta të teologjisë dhe filozofisë, ku mësoi greqishten e lashtë, latinishten. lexoi klasikët e antikitetit helen, Sofokliun, Eskilin dhe Euripidin. Filloi të shkruante me pseudonimin Lyricus.

Më 9 dhjetor 1946 pat ra në burg, ishte

njohuritë në greqishten e vjetër, prej të cilës përktheu pjesë nga Bibla - Apostujt dhe Shenjtorët. Pati hasur edhe në një antologji të veprës së Homerit, të cilën e përktheu. Në burg mësoi greqishten e re, spanjishten dhe anglishten. Pas daljes nga burgu i mundimshëm, më 1957 ka punuar te ndërmarrja Zukth-Kashta, në Shkodër në detyrën e llogaritar-normist deri në pensionim shqipëroi disa veprave të autorëve grekë, të Virgjilit dhe "Këngët e Rolandit", dhe të një pune të nisur mbi një fjalor latinisht-shqip, me rreth 65 mijë fjalë, të cilin vdekja nuk e la ta mbarojë.

Leci hyri i vogël në shkollën e Fretnore, të mesmen e vijoi në Gjinnazin "Illyricum". Klasën e fundit të maturën,

e mori në Gjinnazin "28 Nëntori". Pajisi mendjen dhe fisnikëroi shpirtin me kulturën klasike aksidentale. Lum ai nga kush mori mësim, Fishta, At' Gjon Shllakut, Donat Kurtit, Thanas Gegës e të tjerë ishin mësimdhënësit e tij. Fishta, Gjeçovi, Bernardin Palaj, Marin Sirdani, janë përfaqësuesit më tipik të gjuhës dhe të folmes së maleve ka thënë mjeshtri i madh i letrave shqipe, Ernest Koliqi; ndërsa unë pa frikë do të shtoja se Koliqi dhe Camaj janë kampionet më të mëdhenj të folmes më të thekshme që buron nga gjuha e vjetër shqipe.

At' Zef Pëllumbi më tepër në publicistikën historike, ndërsa Danjel Gjeçaj e Lec Shllaku në letërsi janë vijuesit më të denjë letërsisë françeskane. Mbas disa motesh, pas Luftës se Dytë Botërore rrokupujshme kreu shkëlqyeshëm I. L. P. dyvjeçar të Shkodrës, në degën Gjuhë Letërsi, në vitin 1966 kreu edhe studimet e larta universitare në U. T, në fakultetin Gjuhë Letërsi. Emërohet në Teatrin Qendror të Ushtrisë dhe punon dy vjet, prej ku u dërgua në detyrën e regjisorit në "Teatrin Migjeni", në cilin punon gjithë përkushtim nga viti 1950 -1962. Në vitin 1962, hapi dhe drejtoi teatrin e ri profesionist "Skampa" deri më 1970.

Nga viti 1970- 1976, vit kur edhe doli në pension, ka punuar në detyrën fisnike të mësuesit, për letërsi në shkollimin e mesëm të përgjithshëm në Shkodër. Mban titullin "Artist i Popullit" dhe "Qytetare Nderi i Elbasanit", për kontributin e shquar në detyrën e aktorit dhe regjisorit i skenës shqiptare.

Ne vitin 1952 vuri ne skene ne teatrin "Migjeni" komedinë e Molerit "Koprraci", që ishte një ngjarje e bujshme artistike për kohën. Ai theksoi veçanërisht anët e forta e dramatike te komedisë, përçudjen e karakterit të njeriut nga vesi i koprracisë, sikundër qe trajtimi i figurës se Harpagonit nga aktori Zef Jubani. Kjo shfaqje u përsërit 67 here dhe u ndoq nga mbi 23700 spektator me një mesatare 350 spektator për shfaqje.

Tone te zymta tragjike, shoqëruar me ankth që vinte prej rrezikshmërisë, që paraqiste Tuç Maku, u vunë re në inskenimin e dramës "Toka jone" e Kole Jakoves, 1954. Koncepti regjisorial i L. Shllakut i dha një fryme realiste dramës së Ndreku Lucës, "Shtate shaljanet", më 1958, duke iu larguar zgjidhjeve monumentale e patetike dhe duke mësuar sa më shumë vërtetësi historike dhe karaktere të gjalla.

E njoha kur isha në hapat e pare të shkrimeve të mia, e desha kur më respekttoi dhe më afroi buzë vetit. E çmova për herë e më tepër, pasi duke u pjekur e kuptova më qartë. E nderova me bindje se në portretin e tij dallova izoipset e një viganit malesh lataur dhe stolisur me kulturën më të shëndoshte

qytetare. E pashë se, si i ruajtj këto okë të shëndetshme burrimi kurë shumë të tjerë i bjerrën nga politika dhe interesa. Sjelja e tij e mirësishme, njerëzia, fisnikëria dhe thjeshtësia takti me dite me fol me këto, ishin kolonat e karakterit të tij.


Lec për këtë të desha sa ishte gjallë dhe sot të kujtoj me përmallim atje ku gjendesh nder varre. Usta Leci i takon asaj plejade të shkëlqyer profesionistësh, që teatrin foshnjor të Shqipërisë së pas luftës antifashiste e morën për dore e përkëdhelën gjithë dashuri prindërore, e ushqyen, e rritën duke e çuar në majat më të larta të traditës sonë dhe e shndërruan në një tempull të populluar, të dashur për shikuesit, të cilët në këtë altar të artit skenik argëtoheshin dhe edukoheshin njëherazi.

Bagazhin e gjer kulturor, zgjuarsinë e talentin i përdori si mjet, por kurrë si tupan, për të nxjerrë vetën në dukje. I qeshur, i shkueshëm, i dashur, mikpritës mësues shembullor, i lindur për prijës në llogoret teatrale, prandaj qenë fat lum ata alet, që i udhëhoqe ti, me pishtarin e ndezur olimpiq, maratonën e artit. E pra, ata ishin emra që bëjnë nderë tarit tonë kombëtare si Zef Jubani, Pjetër Gjoka, Loro Kovaçi, Adem Kastrati, Paulin, Laca, Lec Bushati, Ndreka Përla, Tinka Kurti, Marie Logoreci, Vitore Nino, Antoneta Fishta, Paulin Lacaj, Demir Hyskja, Rrobert Ndrenika, Vjollca Gega Antoneta Kristo, Thoma Kristo. Zhani Shllaku Beb Shiroka, Viktor Bruçeti, Çesk Vuksaneti e të tjerë.

Lec Shllaku ishte trau kulmorë i teatrit të ri "Migjeni", ku solli njëra pas tjetres vepra fort të lakmuara nga çdo regjisor si "Koprraci" (Moljer, 1952), "Agimi" (K. Jakova, 1952), "Toka jonë" (K. Jakova, 1954), "Sherbtori i dy zotnive" (K. Goldon, 1955), "Tartufi" (Moljer 1955), "Shtërngata" (Ostrovski. 1956), "Angjelo tirani i Padovës" (V. Hygo 1957), "Berberi i Seviljes" (Bomarshe, 1957), "Shtatë shaljanët" (N. Luca 1958), "Banorët e shkalës nr. 6" (K. Dushi 1958), "Dy binjakët venecjanë" (K. Goldon, 1959), "Trumbetjerja" (Sallinskij, 1959).

Lec Shllaku ishte themeluesi teatrit profesionist "Skampa" të Elbasanit, produkt i regjisë së tij ishin pjesë "Lida" (Xh Broja, 1964), "I pesti u zu gjallë" (N. Zoraqit 1966), "Udha e largët" (Arbuzov 1966), "Udha e Zavalive" (Th. Borodan 1967), "Firmat e Vogla" (Th. Borodani, 1968), "Skenderbeu" (L. Shllaku, 1968), "Shqetësimet e Sokratiit" (L. Shllaku, 1968). "Njeriu që pa vdekjen", ku pas shfaqjes aktori me fame internacionale Viktor Eftimiu, në librin e përshtypjeve ka lënë shënimin, Teatrit profesional rumun i mungojnë aktor të tillë si këta, që pashë këtu.

Përveç se maestro i arenës tetatrale Lec Shllaku ka dhënë kontributin e tij të çmuar edhe në kinematografi, duke interpretuar edhe krijuar karaktere të spikatura në filmat "Skënderbeu" (roli i fisnikut - Gjon Kastriotit), "Ngadhënjim mbi vdekjen" (roli i oficerit gjerman i ashpër i frikshëm gjakatare - (1967), "Rruga e lirisë" - (1982). në rolin e malësorit Gjelosh Marashi; "Qortimet e vjeshtës" - (1981), në rolin e priftit, "Plumba perandorit" - (1980), në rolin e Gjykatësit, "Rrugicat që kërkonin diell" - (1975), në rolin Kuestori



i kërbacit, "Yjet e netëve të gjata" - (1972), "Larg barbarve" (interpretoi në gjuhën frenge.

Aktor i gjate, potent, me vullnet e disiplinë stoike artistike, elokuent, me një mimike plastike sipas rolit i vrenjtur, mes hutimit e zemërimit, por i buzëqeshur, i lumtur dhe i dëshpëruar. Gjithsesi ai, mbete gjeneral i bankinës dhe kapiten i fushës së lojës.

Lec Shllaku u shqua si poet, studiues

dhe prozator, duke lëvruar gjitha gjinive letrare, duke shkruar drama, romane, studime, librete opera e operete, përkthye vargje. ndër të cilat vlen të nënvizohen, drama operistike "Halili dhe Hajria", Pomeën 2500 vargësh "Norja e Nika", "Maska Shkodrane", libër studimor mbi lindjen dhe rrugën e zhvillimit të skenës shkodrane, "Loro Kovaçi" monografi, botim i plotë për jetën dhe veprën e tij, "Shtegtimi i monumenteve" (studim), "Dy hapa



në Perëndim" (përshtypje udhëtimesh), "Palokë Kurti", në 145 vjetorin e lindjes (monografi), "Plaka dhe harkoçi miki" (romant), "Historia e një plage" (roman, të cilin e promovon Shoqata Atdhetare "Dukagjini", në sallën e teatrit "Migjeni" dhe me këtë rast i jep titullin "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini"), "Ngatërrim stinësh dhe romanin "Njerëz mes nesh", që mbeti në dorëshkrim së bashku po thuaj me gjysmën e krijimtarisë së tij më i pjekur si librin katër vëllimesh "Jete pezull", ku tregon se si e pat njohur ai Shqipërinë.

Lec Shllaku ishte një latues i talentuar gegnishtes gurgulluese, që gjallon plot frazeologji burimore. Gegnishtja e Shllakut nuk kufizohet brenda gardhiqeve nëndialektore veriore. Si letrar kishte një stil elegant të matur, i thellë, i lidhur nder arsyetime, i armatosur gjer në dhembe dhe depërtues në psikologjinë shoqërore.

Veprat që la pas Lec Shllaku ende, nuk janë bërë objekt studimi e një kritike të mirëfillte profesionale, por ajo duket ballafaqe se ai ishte një njohës i përpiktë i gjuhës lapidare të geqe rojtare dhe bujk i mirë që din me zgjedhë, farën e shëndoshtë, por edhe ta mbjellë në valikën duhur duke siguruar mbirjen e një bime të veçantë, të cilën e herre e prashitë dhe ujitë me plot dashuri.

Leci ishte ju përkushtua arsimimit dhe edukimit të brezave, me të njëjtin pasion si artit dhe librave. Prind shembullorë, fatlum në krye të një dinastie artistesh. Primos (që mban emrin e Gjyshit Prelë), i dhuroi dhuntinë e të shkruarit shkrimtare autoritare studiuës pedagog dhe flamurbajtës i gegnishtes së salvume. Brunos një emër fort i mirënjohur i fali mjeshtërinë e arktimit dhe regjisë. Bruno nuk qëndroi duarkryq dhe gjeti një nuse si vetin Paskualinën, njëren prej aktoreve më të talentuara të brezit të saj, sa simpatike aq edhe gjithë sharm artistik. Mirësinë thjeshtësinë, ëmbëlsinë. fisnikërinë, bukurinë zemërbardhësinë u fali vajzave Rajmonda e Greta, ku pa dyshim adhurimi, debulesa llastica dhe dashuria superiore ishte Rajmonda.

Kjo familje pati një amë si bleta, bijën fisme të Zef Hilit të fshatit Mguille, të krahinës së Pultit. Roza ishte Afërdita e artisti Lec Shkallu, i cili thoshte se gjithë jetën kemi nda tri fjalë me njeri tjetrin, urdhëro, ke të drejtë, më fal dhe është mbyll çdo kapitull. Zhgënjimin më madh nga Leci e pësoj kur e divorcoi vdekja. Ngarkuar me një barre kujtimesh bashkëshortore sa Taraboshi nën përkujdesjen e Mondes, qëndroi deri në moshën 94 vjeçare kur u largua nga kjo botë dhe shkoi në amshim atje ku priste dashuria e vetme e jetës se saj.

Kështu e njoha unë Lec Shllakun, artist dhe njeri të kapur nga bukuria e mirësia e jetës dhe idealet më të epërme njerëzore.

Lec Shllaku, kolosi që njeh Shkodra dhe gjithë Shqipëria ai, sot ka datëlindjen e 100-të, me një kufi të pa ndare mes jetës dhe vdekjes! Ashtu si kështjella shkodrane kujton "Rozafën" mot pas moti, ashtu do kujtohet edhe emri i arkitektit themelues të teatrit profesional në Shkodër dhe Elbasan, Lec Shllaku!

Përgatiti PRELË MILANI

Fran Gjoka: këmbëngulës, produktiv, modest



GËZIM TUSHI
Mjeshtër i Madh

Personalisht me mësuesin e njohur të Lezhës Fran Gjoka më ka njohur rasti. Ka qenë një e diel e disa viteve më parë, kur duke shëtitur nëpër bulevardin e Tiranës bashkë me mikun tim të vjetër, shkrimtarin Viron Kona, ai më prezantoi me të. Më parë as nuk e kisha njohur personalisht, as nuk kisha dëgjuar gjë për të, punën dhe vullnetin e këtij njeriu. Vironi si gjithnjë dashamirës me njerëzit, diçka më kishte folur për një mikun e tij, për lidhjet e tyre miqësore dhe profesionale.

Mësora ndërkaq se Frani ishte një nga bashkëpunëtorët më të rregullt të gazetës dhe skrupuloz në bashkëpunimet e tij. Ajo që më bërë përshtypje duke e parë “nga jashtë” Franin, ishte se mu duk njeri pretenzios dhe me dëshirë për të qenë i “dukur”. Por kafa e parë që pimë tek “Tajvani” atë ditë, më la një tjetër përshtypje krejt të kundërt nga ajo që mendova pa e njohur atë. Ndoshta nga që edhe Vironi kishte ndikuar, duke më folur herë pas here për Franin për shkak të njohjes së tij si njeri, mësues dhe gazetar.

Në të vërtetë thelbi i këtij njeriu me të cilin u prezantova ishte krejt tjetër. Një burrë modest, pak i ndrojtur, me dëshirë të madhe për të dëgjuar, shumë miqësor dhe i hapur. Në vitet në vazhdim të njohjes dhe miqësisë më Franin m'u krijua një tjetër ide, shumë pozitive, e bazuar në intensitetin e njohjes dhe zgjerimin e marrëdhënieve shoqërore dhe profesionale. Rezultantja është se thelbi i këtij njeriu është vërtetë njerëzor. Ai që e njeh atë nga afër sinqeritetin e tij, nuk mund të gabojë në njohjen e personalitetit të tij individual, profesional dhe social.

Ky takim i parë me Franin ka qenë pikënisja e miqësisë dhe pse jo edhe e bashkëpunimeve tona në fushë të dijes sociale, të problematikave dinamike të arsimit dhe interesimeve reciproke qytetare në përgjithësi. Frani është nga ata njerëz që di ta çmojë miqësinë e tjetrit, ai nuk e ka zakon ta shpërdorojë atë, madje duke ruajtur dhe sensin e masës, si kusht për t'i mbajtur sa më gjatë miqësitë e mira.

Që nga ajo ditë që jam njohur me Franin, kam patur dhe vazhdoj të kem vazhdimisht takime miqësore, diskutime për çështje teorike të arsimit dhe të zhvillimeve të jetës shoqërore shqiptare. Me këtë njeri të sinqertë është e mundur të flitet pa paragjykime, hapur dhe në mënyrë miqësore me njëri-tjetrin. Një njeri i butë, miqësor, i përkushtuar për miqtë, që e çmon miqësinë më shumë se shumëçka, me pasion dhe vullnet të shëndetshëm

profesional. Në thelb kjo në mënyrë sintetike është ana e rëndësishme e këtij njeriu, që mua më ka bërë përshtypje. Dashamirës për “tjetrin” dhe të “tjerët”, aspak egoist për arritjet e të tyre, një lexues i rregullt i shkrimeve në gazeta dhe libra të mi në fushë të sociologjisë (midis të cilëve edhe të sociologjisë së arsimit). Për një pjesë të madhe të shkrimeve që unë kam botuar në gazetën e ndryshme, “lajmëtar i parë” i botimit dhe komentuesi i parë i përmbajtjes së tyre, gjithnjë ka qenë Fran Gjoka, i cili asnjëherë nuk ka përtuar të më urojë, të komentojë dhe të më takojë për të biseduar për to.

Ndërkaq më ka bërë përshtypje intensiteti i lartë i punës së tij, jo thjesht si gazetar narativ i përshkrimit të çështjeve konkrete dhe shqetësimeve të arsimit në shkollat e Lezhës, detyrë të cilën e ka bërë me “fanatizëm” profesional dhe intelektual, duke i dhënë “botës pedagogjike” të arsimit lezhjan, historikut të shkollave dhe sidomos personaliteteve me kontribute në arsim, një hapësirë të vazhdueshme, të pamatë dhe të pandërprerë në faqet e gazetës së tij të dashur dhe me të cilën ka bashkëpunuar më shumë, “Mësuesi”. Dhe në se do të vlerësojmë punën, pasurinë dhe larminë e shkrimeve të Franit, do të kuptojmë fare qartë se ai këtë punë e ka bërë me pasion qytetar, ka zbuluar dhe evidentuar vlera, ka lançuar dhe bërë publike njerëz të arsimit, traditën historikisht të njohur të shkollave lezhjane dhe jo vetëm.

Veprimtaria shumëvjeçare e Franit, të paktën në fushën e gazetarisë profesionale, është një punë e cila duhet mbledhur, sistemuar dhe botuar. Sepse krijimtaria e tij është me shumë vlera. Duke e parë pak më gjerë këtë kontribut personal në fushën e arsimit. Frani nuk ka qenë “kronikan” i zhvillimeve sasiore dhe ndryshimeve empirike të arsimit, as thjesht transmetues i transformimeve të përvojave në fushën e mësimdhënies dhe pedagogjisë konkrete. Këtë ai e ka bërë, madje shumë mirë.

Zhvillimet e ditës, dinamikat e ndryshimit, problematikat e modernizimit të mësimimit, pasqyrimi i përvojave të më të mirëve, problemet e arritjeve të personalizuara të mësuesve më të mirë, më të njohur dhe më të spikatur të Lezhës janë stampuar në dhjetëra artikuj problematikë që ai ka shkruar në faqet e gazetës “Mësuesi” por dhe gazeta të tjera.

Një angazhim i fortë prej “lokalisti”, me sens të spikatur për të elaboruar përvojat lokale, problematikat komunitare të zonës së vet. Një zë i sigurt për të afirmuar sukseset dhe arritjet e të tjerëve, një dëshirë që buron natyrshëm prej thelbit të tij për të vënë njerëzit, dhe kontributet e shumë arsimtarëve të Lezhës në vendin e merituar.

Nuk besoj se ka mësues në Shqipëri që nuk e njeh Franin, në mos personalisht, të paktën nga faqet e gazetës “Mësuesi”. Nuk ka individ që lexon këtë gazetë të mos jetë i informuar deri në detaje për arritjet dhe problemet e arsimit të Lezhës. Pikërisht në sajë të punës së këtij njeriu, që është jo thjesht nder i arsimit, por dhe i

gjithë qytetit të tij. Unë të them të drejtën nuk kam patur rastin ta njoh si mësimdhënës në shkollë apo dhe inspektor për çështjet e arsimit në Drejtorinë Rajonale të Lezhës. Por problematika e shkrimeve dhe shqetësimeve profesionale të Franit, e vlerësuar të paktën nga shkrimet e tij në gazetë, flet se pas njeriut modest nuk është profesionisti rutinier, apo ai që thjesht “fotografon” dhe rendit fakte të zakonshme të “botës së shkollës” dhe problemeve procedurale e didaktike të orës së mësimimit apo të komponentëve të tjerë të punës në shkollë.

Gama e interesimeve të Franit për jetën e shkollës, për proceset e modernizimit të saj, nevojat dhe kontradiktat e thella të përmirësimeve të duhura në marrëdhëniet mësues nxënës, problemet e kompetencës së të drejtimit dhe organizimit të punëve në shkollë, etj, janë fakte që tregojnë se ai është profesionist i mirë. Fakti që ai ngrihet mbi problemet e njohura të arsimit dhe shkollave të Lezhës, bën përgjithësim, sjell njohuri psikopedagogjike dhe përvoja të mira, për përmirësimin e të gjithë komponentëve të punës së shkollës, flet fare qartë që pas Franit mësues apo inspektor “fshihet” profesionisti i çështjeve arsimore, njeriu me përvojë. Kjo është njëra anë e njohur e interesimeve të Franit për aspektet teknike të arsimit, shkollës, mësimdhënies, intensivimit të metodave të mësimimit, përhapjen e përvojave të mira kombëtare dhe më tej.

Por Frani ka dhe një “anë tjetër” që duhet njohur dhe evidentuar patjetër. Ai aq sa ka qenë i shqetësuar dhe kontribuues për anët teknike të organizimit të shkollës, mësimimit dhe procesit pedagogjik të mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkollë, kontributi i të cilit nuk është i vogël as i papërfillshëm, po aq është interesuar edhe për problemet e “anës tjetër” të veprimtarisë së punës edukative e formuese të shkollës. Interesimet social pedagogjike janë të qarta, konkrete, bindëse.

Unë kam dijeni të plotë nga bisedat e mia me Franin se ai gjithnjë e ka parë shkollën jo vetëm si institucion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, por si institucionin e rëndësishëm të edukimit dhe formimit qytetar të nxënësve. Ai ka interesime interesante socio-pedagogjike për fenomenet që preokupojnë shkollën, mësuesit dhe të rinjtë, për indikacionet pozitive dhe negative që interferojnë në shkollë në cilësinë e punës së vet dhe që nuk varen më shumë prej saj se sa ambientit të jashtëm social dhe problematikave që prodhon ajo. Në këtë kontekst nuk kanë qenë të rastësishme shikimet e shqetësimeve të shkollës nga kjo anë. Frani ka një verb të fortë të qytetarit të shqetësuar, që nuk shikon vetëm njëherë anë të medaljes së shkollës duke qenë i njëanshëm.

Ai është marrë me problematikat e forta të adoleshentëve dhe rreziqet e vështirësitë e ndërtimit të marrëdhënieve me ta në familje dhe në shkollë, me teknikat dhe mënyrat e komunikimit dhe zgjidhjes së konflikteve të adoleshentëve me mësuesit dhe prindërit e tyre. Dhe në të gjitha raste ai është mundur të sjellë mendim sa më

të bazuar, të analizuar me optikë sociologjike të qartë dhe të shkruara shumë qartë dhe fare kuptueshëm për nxënësin, prindin, mësuesin. Në interesimet e tij kanë qenë problemet e gjakmarrjes si një problem i ndërlikuar, i cili ka impakte jo vetëm në jetën sociale por dhe në veprimtarinë e shkollës dhe zhvillimin normal të fëmijëve të familjeve të ngujuara për shkak të hakmarrjes apo gjakmarrjes.

Nuk kanë munguar as analizat me spektër të gjërë teorik të situatës që pësojnë të rinjtë shkollarë prej ndikimeve degraduese të lëndëve psikotrope. Të cilat kanë efekte paralizuese mbi nxënësit dhe shfaqen pastaj nëveprimtarinë e shkollës në format e shumta të dhunës dhe krimit. Frani ka folur drejt dhe ka trajtuar çështjet e “pasioneve moshore” dhe rreziqet e përdorimit në rritje të drogës, alkoolit dhe efektet mbi të rinjtë dhe jetën e shoqërisë.

Frani është vazhdimisht i shqetësuar si intelektual dhe qytetar aktiv. Sidomos interesimet e tij teorike e praktike janë tejet intensive e të vazhduara, kur është fjala për problemet që shfaqen dhe shqetësojnë atë dhe shoqërinë në fushat e gjëra e delikate të arsimit dhe edukimit. Me veçorinë e natyrshme të tij, që ai problemet e këtyre dy fushave nuk i shikon “en block” dhe nuk i trajton në mënyrë të sipërfaqshme.

Përkundrazi në shkrimet e Franit duket qartë që përvoja e gjatë e punës në sektorin e gjërë të arsimit e ka bërë atë të jetë i angazhuar, interaktiv dhe ndjekës i dinamikave të vazhdueshme të ndryshimit në përmbajtjen dhe format e punës në shkollë dhe jashtë saj. Padyshim ai është një nga vëzhguesit e vëmendshëm dhe “diagnostikues” permanent i dukurive të përgjithshme dhe fenomeneve specifike që shoqërojnë të gjithë komponentët sinkretikë të shkollës. Për të janë në optikë gjithpërfshirëse struktura e shkollës, përmbajtja kurrikulare, cilësia e lëndës dhe e mësimdhënies, marrëdhëniet mësues nxënës dhe problemet e aigurës dhe autoritetit në shkollë, problemet e njëanshmërisë së shkollës dhe kostot e saj mbi nivelin dhe cilësinë e edukimit qytetar të nxënësve.

Shumë të shpeshta janë analizat dialektike e të dyanshme të nevojës së lidhjes kompakte të shkollës me prindërit, komunitetin dhe shoqërinë civile. Kjo optikë e gjërë e interesimeve profesionale të Fran Gjokës, gjëndet e paqyruar në sasinë e panumurt të shkrimeve të tij. Ato janë të pasqyruara pothuaj në të gjithë gazetatat shqiptare, të cilat kanë vlerën e tyre, jo vetëm për autorin por ato mund të shërbejnë si pasurim me përvojë konkrete por edhe si “letërsi pedagogjike” teorike, në shërbim të funksionimit të shkollës dhe rritjes së cilësisë së edukimit dhe mësimdhënies.

Unë besoj se botimi i tyre i kompaktësuar në një libër me natyrë psikopedagogjike, është detyrë, jo vetëm për Franin si autor por edhe për publikun. Një obligim që duhet përmbushur.

Kampi Veror i Projektit “Shpresa” në Velipojë - Verë e mbushur me dashuri, përfshirje dhe shpresë

Në brigjet e bukura të Velipojës, gjatë verës, Kampi Veror i Projektit “Shpresa” u kthye në një oaz gëzimi, bashkimi dhe përfshirje sociale për dhjetëra fëmijë, të rinj dhe familje me sfida të ndryshme. Nën dritën e diellit dhe përballë detit, Projekti “Shpresa” u bë një hapësirë e gjallë për përfshirje dhe rikthim shprese për qindra fëmijë, të rinj, nëna dhe persona me aftësi të kufizuara, të cilët përballen çdo ditë me sfida të mëdha në jetën e tyre. Me pjesëmarrjen e mbi 270 personave në total gjatë tre turneve, kampi shërbeu si një hapësirë e sigurt, e dashur dhe frymëzuese për ata që shpeshherë qëndrojnë në hijet e shoqërisë.

Gjatë muajit korrik, në bregun e bukur të Velipojës, ndodhi diçka më shumë se një kamp veror. Për të gjithë pjesëmarrësit – fëmijë, të rinj, persona me aftësi të kufizuara dhe familjarë – ky kamp ishte një mundësi për të marrë frymë lirisht, për të pushuar, për të ndjerë që nuk janë vetëm. Projektuar me kujdes, dashuri dhe profesionalizëm nga stafi organizativ i Shoqatës “Shpresa”, nën drejtimin e devotshëm dhe të pakursyer të Z. Luigi Mila, ky kamp nuk ishte thjesht një vend pushimi, por një hapësirë për përfshirje sociale, ndërtim marrëdhëniesh frytdhënëse dhe rikthim të dinjitetit tek secili.

Tre turne, shumë zemra që u lidhën:

Turni i parë (1–15 korrik) mblodhi vajzat e shtëpisë familje “Arcobaleno”, dhe kujdestarët social, nëna me fëmijë me aftësi të kufizuara nga Shkodra dhe zonat përreth, si dhe vullnetarë e kujdestarë që bënë çdo ditë të veçantë. Me ndihmën e shoqatave partnere dhe famullive lokale, kampi u kthye në një vend ku secili ndjeu kujdesin dhe vëmendjen që i takon.

Mbrëmja e fundit u shndërrua në një festë të paharrueshme – një koncert i gjallë me këngëtarin e njohur Hysni Kelmendi, vajzat e tij dhe DJ-t që krijuan një

atmosferë elektrizuese. Ishte një natë ku emocionet u derdhën pa ndrojtje, ku valëzimi e kënga nuk njihnin kufij.

Turni i dytë (17–30 korrik) mirëpriti djemtë e shtëpisë familje “Sole”, vajzat e shtëpisë familje “Speranza” në kujdesin e veçantë të kujdestarëve socialë si dhe persona me aftësi të kufizuara nga organiza-

sesshëm. Vullnetarë nga Roma, vullnetarja e përhershme nga Salamanca, prof. Rosa María Herrera García dhe 17 skautë nga Rimini, krijuan një bashkëjetesë të veçantë, ku kultura, respekti dhe energjia rinore u bashkuan në shërbim të një qëllimi më të madh.

Pushimi – e drejtë dhe domosdosh-

lojërat, sportet dhe momentet e relaksit në natyrë, çdo ditë e çdo moment ka sjellë një aventurë të re! Dhe sigurisht, nuk ka munguar freskia dhe kënaqësia e notit në det – një nga përvojat më të dashura për pushuesit. Një vend ku pushimi u kthye në fuqi, në rikuperim dhe në ndjesinë e shumëkërkuar të përkatësisë.

Vullnetarizmi – zemra e çdo ndryshimi: Çdo moment i bukur i këtij kampi u bë i mundur falë vullnetarëve – nga Shqipëria dhe Europa, që zgjodhën të japin kohën dhe energjinë e tyre për të sjellë buzëqeshje. Ata nuk sollën thjesht ndihmë – sollën zemër, sollën frymëzim dhe dëshmuar se dashuria në veprim është forca më e madhe që kemi.

Prandaj, nëse ke ndjerë ndonjëherë dëshirën për të kontribuar, ky është vendi ku mund të nisësh. Vullnetarizmi nuk ndryshon vetëm jetën e dikujt tjetër – ai transformon edhe ty.

Mbështetje që jep shpresë – kur institucionet bëhen pjesë e së mirës: Vizitat zyrtare nga figura publike si Nënkryetarja e Bashkisë Shkodër Znj. Teuta Shala Qyteza, Drejtoresha e Shërbimeve Sociale Znj. Arlinda Bilali Kruja, deputetja Znj. Marjana Koceku, e të tjerë persona publik me kontribut social si dhe pjesëmarrja në media vendore si Radio Shkodra, tregojnë se ky kamp nuk është më vetëm një iniciativë shoqërore – por një model i vërtetë për bashkëpunim midis shoqërisë civile, institucioneve dhe komunitetit. Këto vizita treguan se kur shoqëria civile dhe institucionet bashkëpunojnë, ndryshimi është real dhe i prekshëm. Pasqyrimi në media kombëtare dhe ndërkombëtare (emisioni italian “Lo Scarto Inascoltato”) po ashtu forcoi më tej ndikimin pozitiv të kampit dhe frymën që ai përcjell. Ky mbështetje na frymëzon dhe na motivon të ecim përpara me më shumë guxim dhe përgjegjësi.

Një kamp që frymëzon dhe mbjell shpresë: Përmbledhtazi, kampi Veror i Projektit “Shpresa” përfundoi, por ndikimi i tij do të ndihet gjatë, ndikim ky që vijon që nga themelimi i tij nga Dok. Silvana Vignali. Në zemrat e pjesëmarrësve që u ndjenë të vlerësuar. Në kujtimet e nënave që gjetën pak qetësi. Në sytë e vullnetarëve që panë se dashuria nuk ka nevojë për shumë fjalë, vetëm për prani.

“Shpresa” nuk është vetëm një projekt – është një përvojë që frymëzon, bashkon dhe ndryshon jetë. Është një dritare që hapet për të parë më qartë, për të besuar më shumë dhe për të dashur më fort. Një verë e tillë nuk mbyllet kurrë – ajo jeton në kujtimet, në marrëdhëniet dhe në shpresën që kemi për një botë më të drejtë dhe më njerëzore

Përgatitur nga znj. SUELA NDOJA,
Anëtare e Kryesisë së Shoqatës
Atdhetare “Dukagjini”



tat “Madonnina del Grappa” dhe Institutit i Motrave të Nënë Terezës. Të rinj vullnetarë nga Shqipëria, Italia dhe Spanja sollën jetë dhe ngjyra në çdo aktivitet. Në fund, një “Pizza Party” simbolizoi jo vetëm fundin e kampit nën kujdesin e veçantë të Z. Fabrizio Nocchi por edhe shijen e një jave të paharrueshme – të thjeshtë, të ngrohtë dhe njerëzore.

Turni i tretë, me 87 pjesëmarrës nga shtëpitë familje “Nido”, “Aquilone” dhe “Arca”, ishte një tjetër kapitull i suk-

mëri për të gjithë: Për këta fëmijë, të rinj dhe familje në nevojë, pushimi nuk është luks – është një formë e respektit dhe kujdesit. Ata që përballen çdo ditë me sfida të rënda sociale, ekonomike apo shëndetësore, kanë po aq të drejtë të ndihen të lirë, të gëzojnë, të kenë kujtime të bukura dhe të ndihen të përfshirë në jetë. Kampi ishte për ta një vend ku nuk kishte më etiketime, por vetëm miqësi. Nga mëngjeset plot energji e vaktet ushqimore të shijshme, tek aktivitetet krijuese, muzika,



Vendit tëm

Kur te vdes, le te bahem bar
Ne malet e mia ne pranvere
Ne vjeshte do te bahem fare.

Kur te vdes, le te bahem uje
E fryma eme avull
Ne fush do te bie shi.

Kur te vdes, le te bahem gur
Ne skajin e vendit tim
Te qindroj kufi.
Drekë malsore
Sot ashtë marrë një gjak.
Dy plumba lëshuen përdhe një burrë.
Sot ashtë marrë një gjak.

Nën tunin e spatës
Pëlset rrashta e kaut te prroni.
(Drekë të mëdha po bahen sot!)

Sot ashtë marrë një gjak.

Gjama e burrave tërbueshëm
Përzihet me erën e mishit ndër zjarme.
E gjethi i Vjeshtës bie i djegun mbi kapuçat e bardhë
Ndë tryeza, jashtë

Natë. Në vorrezat mbi kodër
Tokë e re, hanë e re.
Ujqit janë ulë prej malesh
E pijnë gjak në përrue.
Lule
Sonte më lajmëruen se ka vdekë një njeri
Prandej jam i trishtueshëm, Lule.

Dashunia ashtë e vetmja shtyllë guri
Kur andej gardhit fluturojnë
Shëgjetat e akullit.

Dy zemra bashkë janë ma rrufeprojsje
Se dy shpata tu për tu
Me teha përjashta
Ideja e sosjes, Lule,
kur je ti pranë ik si shpend i egër
andej kah vjen terri.

Vrasja e poetit

Liria e fshehun mbas vargjeve
Të poezisë
Nuk ishte vetëm:
Para tynë rrishin galue roje
Shpend mishngranës
Me fytyrë njerëzore.

E ti ishe për ta një bletë
Tue u rropatë ka drita në qelq,
andej kufijve të botës
njerëzore.

Motiv i vjetër në kthim

Shtatë vasha u çuen peshë
kur ngjyra e korbit fluturoi
përmbi shtyllën e jetës:
sqepi i dukej i verdhë, gati i bardhë
mes pendlave të zeza.
Shtatë vasha u çuen peshë
e u turrën vrap me funda
në duer sa qethi mbas korbave
e vetëm me za i tretën si plafa të murmë



nën karmat e vendit tim.
Po s'erdhët ju, vasha,
kur të zbardhen pusat e ujit
në lumë përpara agimit,
ngurzohen ehde duert e foshnjeve
në palarë.
I përzgjedhi për këtë numër, Gjon Fierza

Ruaju nga zemërimi i njeriut të duruar

Durimi është një virtut i rrallë dhe i çmuar që shpesh na mëson si të përballojmë sfidat e jetës me qetësi dhe mençuri. Por çfarë ndodh kur kjo qetësi prishet? Zemërimi i një njeriu të duruar nuk është si çdo zemërim tjetër; ai është një shpërthim i akumuluar, i ndërtuar pas një periudhe të gjatë vetëkontrolli dhe përpjekjeje për të ruajtur ekuilibrin. Pikërisht për këtë arsye, duhet pasur kujdes nga ai zemërim, sepse forca që e mban durimin gjallë mund të kthehet në një energji të papërbalueshme kur ai kufi thyhet.

Njeriu i duruar zakonisht përpiket të shmangë konfliktet, duke ndjekur rrugën e mirëkuptimit dhe faljes. Ai sheh përtej gabimeve të vogla dhe i jep kohë të tjerëve për të reflektuar mbi sjelljet e tyre. Mirëpo, kjo ndjeshmëri dhe mirëkuptim mund të merren shpesh për dobësi. Kur të tjerët e shfrytëzojnë këtë cilësi duke e tejkualuar kufirin e arsyes, atëherë edhe më i duruari mund të ndihet i zhgënjyer, i lënduar dhe i detyruar të reagojë.

Zemërimi i një njeriu të duruar është si një stuhi që pason një ditë të gjatë me diell. Ai nuk vjen pa paralajmërim, por kur vjen, është i fuqishëm dhe i pamëshirshëm. Kjo ndodh sepse ky zemërim nuk është një emocion impulsiv; ai buron nga një vend i thellë zhgënjimi dhe padre-

jtësie. Njeriu i duruar nuk shpërthen lehtë, por kur e bën, çdo fjalë dhe veprim ka peshë të madhe dhe shpesh lë gjurmë tek ata që janë përfshirë.

Kjo shprehje e zemërimit na kujton se durimi ka kufij dhe se është e rëndësishme të mos abuzojmë me mirëkuptimin dhe tolerancën e të tjerëve. Të respektosh një person të duruar nuk do të thotë thjesht ta admirosh për qetësinë e tij, por edhe të kuptosh që durimi i tij nuk është i pafund. Në vend që të testojmë kufijtë e durimit të të tjerëve, duhet të punojmë për të qenë më të ndershëm, më të drejtë dhe më të ndërgjegjshëm në marrëdhëniet tona.

Në fund, shprehja "Ruaju nga zemërimi i njeriut të duruar" na bën thirrje të reflektojmë mbi veprimet tona. A po respektojmë të tjerët dhe durimin e tyre? A po i shfrytëzojmë ata që zgjedhin paqen mbi konfliktin? Kjo ese është një ftesë për të ndërtuar marrëdhënie të bazuara në respekt dhe mirëkuptim, duke kujtuar gjithnjë se çdo njeri, sado i duruar, ka një kufi që nuk duhet kaluar.

RUZHDI GASHI



REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj
Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,
Suela Ndoja, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia
Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja,
Vilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza,
Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

**MUNDËSOI BOTIMIN
VALENTINA LUCA,
KOMUNA FOLIGNO
PERUCHE, ITALI**

